



Analizë e sistemit arsimor në Kosovë

Autor: Luljeta Aliu



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



Inject
Initiative for
Justice and Equality

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdo ato të Friedrich-Ebert-Stiftung apo të organizatës për të cilën punon autori.

Publikimi mund të gjendet online te www.fes-kosovo.org

PËRMBAJTJA

1 / HYRJE	7
2 / ORGANIZIMI I SISTEMIT ARSIMOR NË KOSOVË	12
2.1 Korniza ligjore dhe institucionale	14
3 / PLANI STRATEGJIK PËR ARSIM 2017–2021: SYNIMET DHE SFIDAT	17
3.1 Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	18
3.2 Menaxhimi i sistemit arsimor	19
3.3 Sigurimi i cilësisë	21
3.4 Zhvillimi profesional i mësimeve	23
3.5 Mësimdhënia dhe të nxënit	25
3.6 Arsimi dhe aftësimi profesional	27
3.7 Arsimi i lartë	30
4 / NIVELI PARASHKOLLOR	33
4.1 Numri i institucioneve parashkollore	34
4.2 Shpërndarja gjeografike e institucioneve parashkollore	34
5 / INSTITUCIONET ARSIMORE NË NIVELIN PARAUNIVERSITAR	38
6 / ARSIMI I LARTË	49
7 / PLAN–PROGRAMET (KLASAT 6 – 12): SI AFTËSOHEN NXËNËSIT PËR JETËN DEMOKRATIKE DHE TË TREGUT TË PUNËS?	65
8 / OFRIMI I KËSHILLIMIT PËR KARRIERË	71
9 / PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIMET	72
10 / REFERENCAT	75

PARATHËNIE

Para gjashtë muajve, Fondacioni Friedrich-Ebert (FES) e ka përkrahur themelimin e lëvizjes së shoqërisë civile e cila për fokus kishte nevojat dhe dëshirat e qytetarëve për të pasur perspektiva më të mira në vendin e tyre: "Kosova që Ne Duam".

Kjo lëvizje tubon organizatat e shoqërisë civile, sindikatat dhe partitë të cilat janë të interesuara për një pjesëmarrje aktive në angazhimet për më shumë siguri sociale, arsim më të mirë, më shumë vende pune dhe korniza administrative dhe juridike më të mira dhe më stabile në Kosovë. Prandaj, jo vetëm që ka nevojë për kritikizëm, por po ashtu edhe për ide për Kosovën që ne duam.

Një fushë substanciale e punës është arsimit dhe lidhja e tij me perspektivat e zhvillimit të tregut të punës. Për të pasur për bazë një informacion gjithëpërfshirës, FES-i ka kërkuar nga autori që të paraqes një pasqyrë të shkurtër për sistemin aktual të arsimit dhe kornizat ligjore ekzistuese. Me këtë fletushkë të vogël, por shumë gjithëpërfshirëse, ne duam t'ju mundësojmë të gjithë njerëzve të interesuar dhe organizatave pjesëmarrjen nëpër debate për të diskutuar për mënyrat më të mira të përmirësimit të arsimit në vend. Mirëpo, kjo është edhe thirrje për të marrë pjesë në mënyrë aktive në aktivitete dhe diskutime publike. E ardhmja e Kosovës ka nevojë për angazhim aktiv të qytetarëve të vet të cilët janë të mirëinformuar.

Frank Hantke

FES-Kosova
Drejtor

1

HYRJJE

Sektori i Arsimit vazhdon të mbetet një nga sferat më të kritikuar dhe më të ndjeshme shoqërore në Kosovë.

Vështirësitë me të cilat përballlet arsimit në Kosovë janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga mungesa e infrastrukturës së mjaftueshme shkollore, performanca e dobët e mësimit dhe mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për trajnimin e mësimit dhe mësuesve, materialet mësimore të papërshtatshme për plan-programin e re dhe mungesa e mekanizmave për sigurimin e cilësisë. Për pasojë, suksesi i çfarëdo përpjekjeje për përmirësimin e arsimit përmes intervenimeve në njërin nga këto nën-fusha ndërlidhet ngushtë me dhe varet nga përpjekjet në nën-fushat e tjera, pasi që të gjitha nën-fushat ndërlidhen mes vete. Sidoqoftë, nëse nisemi nga parimi i zgjidhjes së vështirësive në fillim të zinxhirit dhe sigurimit të qëndrueshmërisë së zgjidhjeve,

atëherë prioriteti i arsimit në agjendën qeveritare dhe rritja e buxhetit për këtë sektor janë dy veprime emergjente që duhet të ndërmerren.

Ky hulumtim ka për qëllim analizimin e kornizës ligjore dhe të dokumentacionit e statistikave aktuale. Hulumtimi synon të ofrojë një përmbledhje analitike gjithëpërfshirëse të gjendjes së arsimit në Kosovë. Të gjeturat e këtij hulumtimi do të shërbejnë si pikënisje për diskutimin e nevojave dhe mangësive në sistemin arsimor në Kosovë.

Përpjekjet për përmirësimin e sistemit arsimor gjatë dekadave të kaluara janë fokusuar në gjithëpërfshirje, ndërtimi të institucioneve dhe infrastrukturës përcjellëse shkollore dhe në rritje të pagave të mësimit dhe mësuesve. Kjo strategji ka arritur t'i përmirësojë pikat në të cilat ishte fokusuar, mirëpo nuk ka arritur sukses në përmirësimin e gjithëmbarshtëm të sistemit arsimor në Kosovë.

Në vitin 2015 Kosova ka marrë pjesë për herë të parë në testin ndërkombëtar PISA, ku ishte renditur në nivelin më të ulët të arritshmërisë në Evropë. Nxënësit kosovarë mbeten edhe prapa atyre në Amerikën Latine, Azi dhe Lindje të Mesme. Meqë në PISA çdo 40 pikë vlejnë sa një vit shkollim, nxënësit kosovarë, në krahasim me nxënësit e Shqipërisë, janë 1 vit mbrapa, ndërsa në krahasim me ata të Serbisë 2 vjet mbrapa.

Këto rrethana kërkojnë një hulumtim dhe analizë të shkaqeve që duhet trajtuar për të arritur sukses në reformën e arsimit në Kosovë. Arsimi, dhe rrjedhimisht profesionalizimi i fuqisë punëtore, është i domosdoshëm për të qenë konkurrentë në tregun e punës brenda vendit, por edhe jashtë tij. Investimet e huaja në Kosovë do të fillojnë tek atëherë kur do të kemi punëtorë të kualifikuar për profesione që kërkohen në treg të punës.

Sistemet arsimore analizohen në raport me tre tregues: 1. qasja në institucionet

shkollore, 2. cilësia dhe 3. relevanca e arsimit për tregun e punës. Megjithëse është punuar shumë në ndërtimin e infrastrukturës, Kosova akoma nuk e ka arritur nivelin e kënaqshmërisë në pikën e qasjes në institucionet arsimore. Në Kosovë shkollat edhe më tej punojnë me ndërrime, si dhe mungojnë hapësirat e mjaftueshme për nxënës, sipas standardeve ndërkombëtare, dhe pajisjet e nevojshme për laboratorë e punëtori. Sa i përket cilësisë dhe relevancës së arsimit për tregun e punës, Kosova edhe më tej gjendet në fillim të procesit për përmirësimin e tyre. Një ndër arsytet e kësaj gjendjeje është fokusimi i politikë-bërësve në arsimin e lartë (universitar). Megjithatë, cilësia në arsim sigurohet kryesisht përmes intervenimit për përmirësimin e arsimit parauniversitar.

Përmes Planit Strategjik për Arsimin Parauniversitar 2017–2021 bëhen përpjekje për zgjidhjen e sfidave në sistemin e arsimit përmes një qasjeje tematike ndër-sektoriale për trajtimin e këtyre sfidave

konkrete. Fjalët kyçe të planit të ri strategjik janë: gjithëpërfshirja, cilësia dhe llogaridhënia.

Në kuadër të gjithëpërfshirjes, në këtë Plan Strategjik është bërë temë për herë të parë edhe numri i ulët i fëmijëve të grup-moshës së hershme, prej 0 deri në 5 vjet, në institucionet parashkollore në Kosovë.

Sa i përket cilësisë në arsim, vetë Plani Strategjik thekson se "sigurimi i cilësisë është një ndër pikat më të dobëta të arsimit parauniversitar në Kosovë".¹ Si përgjigje ndaj kësaj, në vitin 2015 Kosova për herë të parë kishte hartuar Strategjinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar 2016–2021. Tri shtyllat kryesore të këtij dokumenti ishin: reformimi i procesit të mësimdhënies për një mësimdhënie moderne, ndërtimi i karrierës së mësimdhënësve gjatë gjithë jetës dhe fuqizimi i aspekteve praktike të plan-programeve. Ky riorientim ishte më se i nevojshëm duke pasur parasysh se rritja e pagave për mësimdhënësit, që ishte

menduar të shërbente si motivim për performancë më të mirë të tyre dhe rrjedhimisht për përmirësim të cilësisë, doli të ishte e pasuksesshme. Pagat e mësimdhënësve u rritën nga 240 euro në vitin 2010 në 430 euro në vitin 2016, pa u shënuar ndonjë përparim në përmirësimin e cilësisë

Arritja e suksesit në përmirësimin e cilësisë ka qenë nevojë e kamotshme. Megjithatë, akterët kyçë të sistemit arsimor, në dokumentacionet e tyre të publikuara, e kanë kritikuar mungesën e qartësisë në legjislacion sa i përket ndarjes së përgjegjësive lidhur me sigurimin e cilësisë. Përderisa Inspektorati i Arsimit ka të drejtë të merret me çështje administrative dhe komunat mbajnë përgjegjësi formale për sigurimin e cilësisë, është theksuar se në realitet ka pështjellime mbi ndarjen e përgjegjësive ndërmjet autoriteteve qendrore dhe atyre lokale.²

Shpenzimet publike në arsim janë rritur vazhdimisht, nga 3.3% e BPV-së në vitin 2007

¹Plani Strategjik i Arsimit Në Kosovë 2017–2021, 2016, 62.

²Plani Strategjik i Arsimit Në Kosovë 2017–2021, 63.

në 4.7% të BPV-së në vitin 2014. Këto shifra e bëjnë Kosovën të krahasueshme me vendet e rajonit, mirëpo kur merren si bazë krahasimi shpenzimet për kokë banori, Kosova mbetet prapa vendeve të tjera. Arsyeja për këtë dallim është BPV-ja e ulët dhe popullata e re. Shpenzimet për kokë banori në arsimin parauniversitar në vitin 2014 ishin 477 euro (ose 16.1% e BPV-së) për kokë banori, ndërsa në arsimin e lartë 703 euro (ose 23.8% e BPV-së) për kokë banori. Në vendet e OBEZh-it, shpenzimet për nxënës nga institucionet arsimore arrijnë mesatarisht në 21% të BPV-së për kokë banori në nivelin fillor, 26% në nivelin e mesëm, dhe 41% në nivel terciar.

Ekspertët e arsimit kanë kritikuar ndarjen e vogël të buxhetit për arsye politike. Për zbatimin e strategjisë së re janë paraparë 80 milionë euro për një periudhë pesëvjeçare, ndërsa gjatë vitit 2017 është dashur të sigurohen 20 milionë euro, mirëpo kjo nuk ka ndodhur.³

Buxheti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për vitin 2018 është planifikuar të jetë 54.92 milionë euro, ndërsa në vitin 2017 ishin planifikuar 45.13 milionë euro.⁴ Nuk ka pasur ngritje të investimeve në nivelin parauniversitar, ndonëse vetë Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Plani Strategjik i Arsimit theksojnë nevojën e intervenimit në këtë nivel.

Sipas të gjeturave, kualifikimet e mësimit dhe përgatitja e tyre nuk janë adekuate për të mbuluar nevojat që dalin nga plan-programi i ri. Gjithashtu ka mungesë mësimit të disiplinave shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë.

Megjithëse plan-programi i ri, i bazuar në nxënës dhe zotësi praktike, është dashur të zbatohet që nga viti 2004, për vite me radhë ka pasur ngecje në këtë drejtim. Rezistencë ndaj reformës ka pasur sidomos nga ana e mësimit, të përfaqësuar nga SBASHK-u. Prej vitit të kaluar MASHT ka filluar zbatimin e plan-

³Radio Evropa e Lirë: <https://www.evropaelire.org/a/28238678.html>

⁴Portali Telegraf: <https://telegrafi.com/rritjet-dhe-shkurtime-buxhetore-te-vitit-2018/>

programit të ri në të gjitha shkollat. Për zbatimin efikas të plan-programit të ri mungojnë edhe tekstat mësimore të përditësuara me qëllim të arritjes së objektivave të tij.

Nga këto të dhëna del në pah se sistemi arsimor në Kosovë i mungon orientimi strategjik, e gjithashtu edhe Qeverisë, e cila duhet të ndajë më shumë mjete për investime në arsim. Strategjia Kombëtare për Zhvillim si shtyllë të parë kryesore thekson zhvillimin e kapitalit njerëzor përmes investimeve në arsim, pasi që ngecjen e zhvillimit ekonomik e sheh si rezultat të mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar. Sa i përket zhvillimet të ulët ekonomik, Strategjia Kombëtare për Zhvillim thekson se "një ndër shkaqet kryesore qëndron te sistemi i arsimit, gjegjësisht tek përfshirja e ulët e fëmijëve në programe parashkollore dhe tek cilësia e mësimdhënies. Problem tjetër gjithashtu përbën mungesa e përputhshmërisë së aftësive dhe shkathtësive të fituara me kërkesat e tregut të punës, teksa mungojnë lidhjet në

trekëndëshin ndërmjet shkollave, bizneseve dhe komuniteteve."⁵ Megjithatë, Qeveria nuk e ka ndarë buxhetin e nevojshëm për intervenime dhe investime në arsim. Sikurse në vitin 2017, edhe në vitin 2018 mjetet e ndara për arsim kanë qenë të pamjaftueshme për arritjen e prioriteteve të planifikuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim. Kjo nënkupton se Qeveria dhe organet më të larta shtetërore nuk i përfillin planet dhe strategjitë e tyre të përpiluara për avancimin e shoqërisë. Planifikimet dhe zotimet e strategjive të shumta shpeshherë devijohen për arsye politike partiake dhe zgjedhore.

⁵Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016–2021, 2015, fq. 6.

2

ORGANIZIMI I SISTEMIT ARSIMOR NË KOSOVË

Sistemi arsimor në Kosovë është i strukturuar si në vijim:

- Arsimi parashkollor (fëmijë të moshës < 6-vjeçare);
- Arsimi fillor (klasat 1-5, fëmijë të moshës 6 – 10-vjeçare);
- Arsimi i mesëm i ulët (klasat 6-9, fëmijë të moshës 11 – 14-vjeçare);
- Arsimi i mesëm i lartë (klasat 10-12, fëmijë të moshës 15 – 18-vjeçare); dhe
- Arsimi i lartë.

➤ **Niveli fillor** në Kosovë zgjat 5 vjet, duke filluar nga klasa e parë deri në klasën e pestë (1 – 5). Grup-mosha e nxënësve në këtë nivel është nga 6 deri në 10 vjeç.

➤ Niveli i mesëm i ulët shtrihet nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë (VI – IX). Grup-mosha e nxënësve në këtë nivel është nga 11 deri në 14 vjeç.

➤ Niveli i mesëm i lartë (klasat X – XII) funksionon në shkolla të mesme publike dhe jopublike

(të licencuara) dhe ndahet në gjimnaze dhe shkolla profesionale. Të dy kategoritë janë shkolla të profilizuara. Gjimnazet ndahen në këto drejtime: shoqëror, i përgjithshëm, i shkencave natyrore, matematikë-informatikë dhe ai i gjuhëve. Shkollat e mesme profesionale ndahen, sipas drejtimeve, si në vijim: teknike, bujqësore, ekonomike, të mjekësisë, të muzikës, të tregtisë, teologjike, të artit, dhe qendra të kompetencës.

➤ **Arsimi i lartë** gjithashtu ndahet në nivele. Niveli i parë, me 3–4 vite studime, dhe 180 ose 240 kredi ECTS, përfundon me diplomën Bachelor. Niveli i dytë, me 1 – 2 vite studime shtesë pas Bachelorit, me 60 ose 120 kredi ECTS, përfundon me diplomën Master. Në nivelin e tretë të arsimit të lartë mund të ndiqen studime të doktoratës. Në Kosovë arsimi i lartë mund të vijohet në mënyrë të rregullt ose me korrespondencë.⁶

Këtu duhet përmendur se sistemi arsimor i Kosovës ka karakter etnik, për shkak të ndërhyrjes së politikës së Serbisë në zonat ku mësimdhënia mbahet në gjuhën serbe. Serbët e Kosovës ndjekin shkollimin sipas plan-programeve të sistemit arsimor të Serbisë. Prandaj ata nuk përfshihen në shifrat e paraqitur më poshtë në këtë studim, i cili synon përmirësimin e sistemit arsimor aktual të Kosovës. Edhe sistemi i arsimit të lartë menaxhohet nga strukturat politike të Mitrovicës Veriore, së bashku me Qeverinë e Serbisë

Kosova në sistemin e arsimit të saj publik përfshin 43 institucione parashkollore, 952 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, 119 shkollave të mesme të larta, dhe 9 institucione

publike të arsimit të lartë. Përpos këtyre institucioneve, në Kosovë funksionojnë edhe 88 institucione private në nivelin parashkollor, 10 institucione private të licencuara që ofrojnë arsimim fillor dhe të mesëm, si dhe 30 institucione të licencuara të arsimit të lartë privat.

Pas miratimit të Kornizës së Kurrikulës është hartuar baza ligjore dhe dokumentet përcjellëse për zbatimin e saj. Sipas planifikimit të MASHT-it, pritej që Kurrikula të zbatohet në të gjitha shkollat e Kosovës gjatë periudhës 2011–2014. Gjatë viteve 2013 – 2014, pilotimi i plan-programit ishte realizuar fillimisht në 10 shkolla, ndërsa një vit më vonë zbatimi i tij ishte zgjeruar në 92 shkolla në 30 komuna. Disa nga problemet që kanë përcjellë shtrirjen e ngadalshme të plan-programit të ri janë: numri i vogël dhe përgatitja e pamjaftueshme e trajnerëve të fushave lëndore për të aftësuar, mentoruar dhe monitoruar mësimdhënësit gjatë zbatimit të plan-programit në klasa, kapacitetet e kufizuara profesionale dhe financiare në sistemin arsimor, vonesat në përgatitjen e materialeve përcjellëse për zbatimin e tij, si dhe mungesa e teksteve shkollore të përshtatshme.

⁶Statistikat e Arsimit në Kosovë–2016–17* (Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim, 2017), 13.

Një nga pengesat kryesore për përmirësimin e arsimit është mungesa e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet. Gjatë hulumtimit është vënë re se kjo çështje është temë diskutimi në disa raporte dhe strategji.

Për shembull, në dokumentin "Strategjia për Sigurimin e Cilësisë", thuhet: "Përderisa Inspeksioni i Arsimit ka të drejtë të merret me çështjet administrative (Ligji, 2004) dhe komunat mbajnë përgjegjësi formale për sigurimin e cilësisë, në realitet ekziston një konfuzion mbi ndarjen e përgjegjësiave mes autoriteteve qendrore dhe lokale."⁷ Edhe në Planin Strategjik për Arsim 2017–2021 theksohet se ekziston një pështjellim në legjislacionin aktual.⁸ Kjo mbase ka pasur për pasojë neglizhimin e qasjes proaktive për sigurimin e cilësisë, ngaqë asnjëri prej akterëve nuk e ka

pasur të qartë obligimin e tij dhe përgjegjësitë janë parë tek të tjerët.

Sidoqoftë, nga analizimi i legjislacionit aktual gjatë këtij hulumtimi kemi gjetur se ai ngarkon ministrinë me detyrën e sigurimit të cilësisë. Legjislacioni është i qartë në përcaktimin e detyrave, përkundër ndarjes së kompetencave ndërmjet akterëve të ndryshëm. Analiza e kornizës ligjore rreth kësaj çështjeje ka përfshirë disa ligje, mes tyre Ligjin për Arsimin Parauniversitar,⁹ Ligjin për Arsimin në Komuna¹⁰, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale¹¹ dhe Ligjin për Inspeksionin.¹²

Në Ligjin për Arsimin Parauniversitar, në nenin 5 (paragrafin 1), thuhet se "Ministria mban përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit parauniversitar".

⁷"Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016–2020." n.d., 11.

⁸MAShT, "Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017–2021," 63.

⁹Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, <http://masht.rks-govnet/uploads/2015/06/1-ligji-per-arsimin-parauniversitar.pdf> [qasur me 22 korrik 2018]

¹⁰Ligji për Arsimin në Komuna, <http://masht.rks-govnet/uploads/2015/06/9ligji-i-arsimit-ne-komuna-2008-03-1068-al-arse-kom.pdf> [qasur me 22 korrik 2018]

¹¹Ligji për Vetëqeverisje Lokale, <https://qzkrks-govnet/ActDetail.aspx?ActID=2530>, [qasur me 22 korrik 2018]

¹²Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, <http://masht.rks-govnet/uploads/2015/06/4-2004-37-al.pdf>, [qasur me 22 korrik 2018]

Sipas këtij neni, Ministria ka për detyrë të zhvillojë politika, të hartojë dhe zbatojë legjislacionin për zhvillimin e arsimit dhe aftësimin parauniversitar, të promovojë, dhe të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e arsimit dhe aftësimin, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Ndërsa DKA-të, sipas Ligjit për Arsimin në Komuna, kanë këto përgjegjësi: a) ndërtimin e objekteve shkollore; b) regjistrimin dhe pranimin e nxënësve; c) punësimin e mësimeve dhe personelit administratës e teknik të shkollave; d) përzgjedhjen e menaxherëve të institucioneve edukativo- arsimore; f) pagesën e stafit menaxherial dhe personelit tjetër (teknik dhe administrativ); e) trajnimin e edukatorëve dhe stafit tjetër profesional; h) mbikëqyrjen e procesit arsimor, në pajtim me udhëzimet e përcaktuara nga MASHT-i.

Plani Strategjik për Arsim 2017-2021, në objektivin strategjik 3 ("Sigurimi i Cilësisë në Arsim") tenton të bëjë

ndarjen e përgjegjësisë lidhur me cilësinë e arsimit ndërmjet nivelit qendror (MASHT-it), nivelit komunal (DKA-ve) dhe shkollave. Sa i përket arsimit për këtë përpjekje, aty thuhet se "alternativa tjetër ka qenë një inspektorat i fuqishëm i arsimit që do të merrte gjithë përgjegjësinë për sigurimin e cilësisë, përderisa komunat dhe shkollat do të zbatonin vendimet e inspektorëve. Është konsideruar se një alternativë e tillë është në shpërputhje me karakterin e decentralizuar të sistemit të arsimit në Kosovë dhe nuk do të jepte rezultate të dëshiruara".¹³

Marrë parasysh se sigurimi i cilësisë është i një rëndësie vendimtare për përmirësimin e arsimit, por edhe rolin që i jepet sigurimit të cilësisë në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (2016), një ndarje e përgjegjësisë ndërmjet tri institucioneve do të rrezikonte që përpjekjet për arritjen sa më të shpejtë të këtij objektivit të jenë të pasuksesshme, për shkak të implikimit të shumë akterëve dhe rrjedhimisht ndërlikimit të kompetencave në lidhje me detyrat dhe

¹³Plani Strategjik i Arsimit Në Kosovë 2017-2021, 40.

përgjegjësitë. Mbi të gjitha, argumentimi se karakteri i decentralizuar i sistemit të arsimit kërkon një ndarje kompetencash në sigurimin e cilësisë, është i pasaktë. Decentralizimi i sistemit të arsimit në Kosovë si i tillë nuk nënkupton se secila komunë duhet të obligohet me sigurimin e cilësisë. Kosova e ka një sistem unik të arsimit, i cili është i njëjti për të gjitha komunat.

Legjislacioni ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve në fushën e arsimit. Detyrat e Komunave janë që të sigurojnë mirëmbajtjen dhe renovimin e objekteve shkollore, si dhe të kryejnë rekrutimin dhe të paguajnë personelin arsimor, ndërsa shkollat janë përgjegjëse për vlerësimin e brendshëm të mësimdhënësve dhe mbikëqyrjen e tyre në punën e përditshme. Është një ngarkesë e papërbalueshme për Drejtoritë për Arsim nëpër Komuna, si në aspektin profesional, e gjithashtu në aspektin e kapaciteteve njerëzore, që të obligohen me sigurimin e cilësisë së arsimit. Kjo do të kishte edhe pasoja

negative për vetë objektivin, meqë nëpër komuna të vogla njerëzit njihen mes vete, gjë që krijon edhe mundësinë e shkëmbimit të favoreve. Prandaj, delegimi i sigurimit të cilësisë nga MASHT tek Drejtoritë e Arsimit në komuna duhet të rishqyrtohet. Kjo sidomos për faktin se askund në legjislacion nuk gjendet ndonjë dispozitë që e ngarkon Komunën me këtë detyrë.

Në kuadër të MASHT bën pjesë Inspektorati i Arsimit. Detyrat e Inspektoratit, në bazë të legjislacionit, kufizohen kryesisht në inspektimin e punëve formale të shkollës dhe të organizimit mësimor të mësimdhënësve. Meqë Inspektorati funksionon në kuadër të MASHT-it dhe fushëveprimi i tij përmban elemente të vlerësimit të proceseve dhe sigurimit të përmbushjes së kriterëve të caktuara, zgjidhja më e mirë do të ishte që ky institucion të rritej në staf dhe t'i jepen kompetencat dhe buxheti i nevojshëm për sigurimin e cilësisë. Strategjitë, planet, por edhe instrumentet për matjen e cilësisë, duhet të zhvillohen

3

PLANI STRATEGJIK PËR ARSIM 2017–2021: SYNIMET DHE SFIDAT

Në vitin 2016 MASHT ka publikuar Planin Strategjik për Arsim 2017 – 2021. Qëllimi i tij është që të vendosë orientimin e zhvillimit në fushën e arsimit. Ky plan është plani i dytë strategjik gjithëpërfshirës. Plani strategjik për vitet 2011 – 2016 ka pasur si qëllim gjithëpërfshirjen e fëmijëve në arsim, me fokus në ndërtimin e infrastrukturës për përmbushjen e nevojave emergjente për hapësira shkollore. Strategjia e viteve 2011–2016 është e organizuar sipas nën-sektorëve të sistemit arsimor (Sektori parashkollor, Sektori parauniversitar, Sektori i AAP-së, Sektori i trajnimit të

mësimdhënësve, Sektori i arsimit të lartë, Sektori i arsimit të të rriturve, Sektori i TIK-ut).

Për dallim nga strategjia e kaluar, Plani Strategjik 2017–2021 është organizuar në fusha tematike të cilat mbulojnë segmentet relevante të arsimit në Kosovë, dhe atë në këto objektiva strategjike: 1. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja, 2. Menaxhimi i sistemit arsimor, 3. Sigurimi i cilësisë, 4. Zhvillimi i mësimdhënësve, 5. Mësimdhënia dhe të nxënit, 6. Arsimi dhe aftësimi profesional dhe arsimi i të rriturve, dhe 7. Arsimi i lartë.

3.1

PJESËMARRJA DHE GJITHËPËRFSHIRJA

Në këtë fushë sistemi arsimor është përballur me disa sfida që kanë të bëjnë me nivelin e ulët të përfshirjes në arsim të fëmijëve nga grupet e marginalizuara dhe fëmijëve me nevoja të veçanta. Por më emergjent ka qenë trajtimi i nivelit të ulët të përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm parashkollor. Përpos në nivelin parashkollor, Kosova ka arritur suksese të mira në gjithëpërfshirje në nivelet e tjera. Zgjidhja më e mire do të

ishte ndërtimi i institucioneve parashkollore, gjë që do të rriste edhe shpenzimet kapitale por edhe do të krijonte qindra vende pune. Megjithatë, për shkak të kufizimeve buxhetore, është vendosur që të ngrihet niveli i pjesëmarrjes në arsimin parafillor, pasi që aty ka shpenzime më të vogla. Njëkohësisht do të stimulohet hapja e institucioneve private dhe me bazë në komunitet.

Vlerësimi i arritshmërisë së objektivit:

Gjatë vitit të fundit Kosova ka shënuar rritje të nivelit të përfshirjes në edukimin parashkollor dhe parafillor. Përfshirja në edukimin parashkollor është arritur kryesisht përmes hapjes së institucioneve private. Një përfshirje më e madhe është arritur në edukimin parafillor, të grupmoshës 5–6 vjeç. Shkalla e përfshirjes në vitin

2017 (92.4%) është ndjeshëm më e lartë se në vitin paraprak (79.5%).¹⁴

Gjatë vitit 2017 janë ndërtuar dy shkolla me tri klasë për mësim parafillor. Gjithashtu është zbatuar projekti për pajisje me material shkollor për disa komuna. Ende është duke u punuar në aftësimin e edukatorëve të arsimit

¹⁴MASHT, "Raport Vjetor i Vlerësimit," 2018, 51.

parafillor mbi plan-programin e ri dhe në hartimin e materialeve mësimore, të cilat janë në pritje të finalizimit të plan-programit bërthamë të

edukimit parashkollor. Duhet të punohet edhe më tej në përfshirjen e grupeve të marginalizuara nga komuniteti rom, ashkali dhe ai egjiptas.

3.2

MENAXHIMI I SISTEMIT ARSIMOR

Pika për intervenim që është identifikuar gjatë hartimit të Strategjisë në fushën e menaxhimit të sistemit arsimor është mungesa e kapaciteteve në nivel qendror, komunal dhe shkollë për zbatimin e reformës në arsim përmes një qasjeje të koordinuar dhe koherente. PSAK synon ngritjen e profesionalizmit menaxherial të drejtorit të shkollës, i cili do duhet të shohë veten si kompetent dhe përgjegjës për të dhënë kontribut konkret në zhvillimin e cilësisë në arsim. Një problem tjetër është

moszbatimi i legjisllacionit primar dhe mosrespektimi i tij gjatë hartimit të legjisllacionit sekondar dhe politikave arsimore. Më tej, është vënë re se politikë-bërja nuk bazohet në të dhëna statistikore nga fusha e arsimit, dhe se mungon vetëdija te të gjitha palët se arsimi është përgjegjësi publike.

Vlerësimi i arritshmërisë së objektivit:

Masat fillestare për ngritjen e kapaciteteve menaxheriale kanë qenë: trajnimi i personelit të MASHT për planifikimi, politikë-bërje dhe monitorim, si dhe për zhvillim të kapaciteteve për raportim dhe planifikim të integruar MASHT-DKA-shkollë. Është ristrukturuar organizimi i DKA-ve dhe janë hartuar rregulloret dhe udhëzuesit për menaxhim në nivel lokal, për fuqizim të autonomisë së shkollave dhe për fuqizim të Këshillave Drejtues të Shkollave.¹⁵ Në të njëjtën kohë ka filluar procesi i vlerësimit vjetor të PSAK-ut, për të monitoruar arritjet e PSAK dhe publikuar raportet vjetore.

Për të përmirësuar procesin e planifikimit MASHT-DKA-Shkollë ka filluar procesi i modernizimit të Sistemit të Informatave për Menaxhim të Arsimit (SMIA). Ky projekt, i mbështetur përmes grantit të Bankës Botërore, parasheh modernizimin e të dhënave arsimore në nivel komune, shkollë dhe nxënësi.¹⁶

Menaxhimi i sistemit arsimor është kompleks shkak i kërkesave për intervenim në shumë aspekte të arsimit, siç janë gjithëpërfshirja, cilësia dhe ndërlidhja e ofertës arsimore me tregun e punës. Megjithëse janë bërë hapa në përmirësimin e planifikimit dhe raportimit, koordinimi me nivelin komunal mbetet sfidues.

Megjithëse është rregulluar procesi i planifikimit dhe menaxhimit mes niveleve të qeverisjes në arsim, ky mekanizëm është ende në fazat fillestare. Plani i Veprimtari i PSAK-ut nuk ka zhvilluar caqe apo veprime për rregullimin e komunikimit vertikal dhe horizontal të akterëve të arsimit. Gjithashtu mungon një rregullim i qartë për administrimin e sistemit arsimor i cili do të përcaktonte rolet dhe përgjegjësitë e sakta të akterëve dhe institucioneve. Gjithashtu mungon sistematizimi i vendeve të punës së menaxhmentit të shkollave, me përshtatje të kompetencave dhe detyrave.

¹⁵MASHT, 72.

¹⁶MASHT, 73.

Cilësia e arsimit në Kosovë është kritikuar vazhdimisht, sidomos pas rezultateve të dobëta në testin ndërkombëtar PISA. MAShT ka përpiluar, në vitin 2015, një Strategji për Sigurimin e Cilësisë. Kjo strategji bazohet në katër objektiva. 1. ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë, 2. avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkolle, 3. ngritja e

kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet, dhe 4. ngritja e vetëdijes për përgjegjësitë e palëve për sigurimin e cilësisë në arsim. Në anën tjetër, Plani Strategjik 2017-2021 diskuton mungesën e administrimit të mirë të testeve kombëtare, besueshmërinë e rezultateve dhe fenomenin e mashtrimit gjatë testeve kombëtare.

Vlerësimi i arritshmërisë së objektivit:

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar "Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020" në dhjetor të vitit 2015. Qëllimi i kësaj strategjie është të prezantojë një sistem të plotë të sigurimit të cilësisë në nën-sektorin e arsimit parauniversitar. PSAK gjithashtu parasheh disa aktivitete për arritjen e këtij objektiv. Aktivitetet kanë të

bëjnë kryesisht me ndërtimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë. MAShT gjithashtu parasheh informimin e prindërve dhe të publikut të gjerë për sigurimin e cilësisë. Një tjetër synim është që të rritet besueshmëria e testeve kombëtare.

Plani i Veprimit nuk i ka definuar veprimet e sakta për përmbushjen e këtij objektiv. Analiza e dokumenteve

strategjike dhe atyre përcjellëse lë të kuptohet se nuk ekziston një përkufizim i qartë i cilësisë dhe aspekteve të saj në asnjë nga nivelet e qeverisjes së arsimit. Mungon ndarja e cilësisë në pjesën e definuar si përmbajtjesore të termit dhe në pjesën procedurale të organizimit të procesit për sigurimin e cilësisë.

Cilësia mund të matet si output (çfarë prodhon), input (çfarë ofron) dhe si proces (si ofrohet). Kjo nënkupton që cilësia do të duhej të sigurohej në momentet kyçe të ciklit të menaxhimit të arsimit, pra në 1. outcome – kur nxënësit kalojnë testet e brendshme dhe të jashtme, 2. kur cilësia matet si input, pra me numrin dhe kualifikimet e mësimit, numër të klasave, materialeve mësimore, dhe 3. kur cilësia si proces vlerësohet në metodat e mësimit, mësimit-nxënies, administrimit dhe menaxhimit të arsimit.

Udhëzimi Administrativ 4/2017 për vlerësimin e performancës së shkollave në arsimin parauniversitar është miratuar

në vitin 2017. Ky udhëzim përcakton instrumentet dhe organet për vlerësim të performancës së shkollës, dhe përgjegjësitë e akterëve për vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Për përmbushjen e vlerësimit të jashtëm të shkollës është definuar roli i Inspektoratit të Arsimit, Drejtorive Komunale të Arsimit dhe institucioneve arsimore.¹⁷ Të gjitha këto aktivitete janë zhvilluar tek vitin e fundit, gjë që do të thotë se deri më tani nuk ka ekzistuar rregullimi i ciklit të sigurimit të cilësisë.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve Inspektorati ka filluar vlerësimin e performancës së shkollave, monitorimin e zbatimit të Kurrikulës së re dhe ka bërë përgatitjet për vlerësimin e performancës së mësimit. Personeli i Inspektoratit është trajnuar për këto procese dhe është anëtarësuar në SICI ('Standing International Conference of Inspectorates', Konferencën Ndërkombëtare të Inspektorateve). Ndërkohë, MASHT, në bashkëpunim me DKA-të, ka caktuar

¹⁷MASHT, 90.

koordinatorët për sigurimin e cilësisë nëpër Komuna, të cilët do të duhej t'u raportonin DKA-ve. Kjo qasje ngërthen në vete dy problematika. Së pari, meqë koordinatorët janë personel i shkollës, ata nuk janë të trajnuar në mënyrë adekuate dhe nuk paguhen

për të kryer detyrën e monitorimit të cilësisë. Së dyti, raportimi rreth cilësisë do t'u binte DKA-ve, të cilat pastaj i raportojnë MASHT-it. Kjo mënyrë e organizimit nuk e siguron cilësinë në arsim në mënyrë efikase dhe efektive.

3.4

ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE

Me këtë objektiv është planifikuar trajnimi i mësimitdhënësve dhe funksionalizimi i sistemit të licencimit të tyre. Licencimi mendohet të kontribuojë në cilësinë e mësimitdhënësve, motivimin e mësimitdhënësve për performancë të mirë dhe të ndihmojë të adresohen rastet e performancës së dobët. Sistemi i licencimit i obligon mësimitdhënësit që gjatë karrierës të ndjekin një numër të caktuar të trajnimeve për zhvillim profesional (100 orë brenda 5

vitesh) dhe kërkon vlerësimin e performancës së tyre. Korniza ligjore për licencimin, ngritjen në detyrë dhe vlerësimin e performancës së mësimitdhënësve është zhvilluar, por akoma nuk është zbatuar. Plani strategjik parasheh që për t'u siguruar një zhvillim profesional i orientuar kah zgjidhja optimale, së pari do të duhet që institucionet publike që përgatisin mësimitdhënës të rinj të bazohen në standarde të unifikuara shtetërore.

Vlerësimi i arritjes së objektivit:

Përpjekje për reformim të sistemit të arsimit ka pasur edhe më herët në Kosovë. Në vitin 2011 MASht ka miratuar Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (KKK), e cila ka mundësuar kalimin nga mësimdhënia e të nxëniet bazuar në objektiva dhe përmbajtje mësimore në metodologjinë bashkëkohore të mësimdhënies e të të nxëniet bazuar në rezultate dhe në zhvillimin e zotësive praktike të nxënësve. Sipas planifikimeve plan-programi duhej të zbatohet gjatë viteve 2011–2014, por ka pasur ngecje në këtë proces, kryesisht për shkak të rezistencës nga ana e mësimdhënësve për të zbatuar plan-programin e ri, për ç'gjë nuk ishin të trajnuar dhe mungonin mjetet për zbatimin e tij. Pilotimi i plan-programit të ri ishte realizua në 10 shkolla, gjatë viteve 2013 – 2014, dhe një vit më vonë ishte zgjeruar në 92 shkolla, në 30 komuna. Duke filluar nga viti i kaluar të gjitha shkollat janë të obliguara të funksionojnë sipas plan-programit të ri.

MASht ka zhvilluar bazën rregullative për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, e cila kërkon që ata t'i nënshtrohen procesit të licencimit, gradimit dhe vlerësimit të performancës. Megjithatë, sistemi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve ka filluar të pilotohet për rreth 130 mësimdhënës, por akoma nuk është shtrirë tek gjithë kuadri. Sistemi i avancimit të bazuar në performacë do të jetë vështirë i realizueshëm për aq kohë sa skema e pagave të jetë lineare dhe e bazuar kryesisht në arritje para shërbimit (kualifikime) dhe përvojën e punës.¹⁸ Kompensimi i mësimdhënësve në Kosovë tejkalon të hyrat mesatare për kokë banori. Ngritja e pagave të mësimdhënësve është bërë për të gjithë. Fatkeqësisht, ngritja e pagës nuk është ndërlidhur me performancën e mësimdhënësve, gjë që do të siguronte në mënyrë më të efektshme ngritjen e cilësisë në mësimdhënie.

Janë trajnuar rreth 40% e mësimdhënësve mbi zbatimin e plan-programit të ri, mirëpo

¹⁸MASHT, 91.

për zbatimin e lëndëve përdoren tekste ekzistuese mësimore të plan-programit të vjetër. Tekstet mësimore nuk janë të përshtatshme në të gjitha rastet për zbatim të plan-programit të ri. Resurset materiale për mësimdhënie, si dhe qasja në tekste mësimore adekuate, kompjuterë dhe laboratorë vazhdojnë të jenë sfidat kryesore. Qasja në

internet nëpër shkolla ekziston, por numri i kompjuterëve për nxënës është i vogël, ndërsa edhe shkalla e përdorimit të tyre nga nxënësit dhe integrimi i tyre në mësimdhënie mbetet e ulët, për shkak të vështirësive të një numri të mësimdhënësve për përdorimin e teknologjisë informative për mësimdhënie¹⁹

3.5

MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

Në vitin 2011 Kosova e ka miratuar Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (KKK), me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit dhe harmonizimit të arsimit me vendet e zhvilluara. Nga kjo kornizë e re e plan-programeve u mundësua kalimi nga mësimdhënia e bazuar në objektiva e përmbajtje në mësimdhënien e bazuar në rezultate dhe

zhvillim të zotësive praktike të nxënësve.

Strategjia e Arsimit 2017-2021 përqendrohet në zbatimin e plan-programit të ri, tekstet shkollore dhe zbatimin e TIK-ut në arsim. Për të gjitha këto fusha janë analizuar alternativa të shumta. Ideja e plan-programit të ri re është që MASHt të përcaktojë

¹⁹MASHt, 108.

zotësitë praktike që duhet arritur dhe të përpilojë plan-programet bërthamë, ndërsa shkollat përmbajtjet mësimore. Mirëpo për shkak të pamundësisë që përmbajtjet

të krijohen nga shkollat, MAShT është i përfshirë në hartimin e përmbajtjeve mësimore dhe tekstet shkollore do të jenë në përputhje me ato përmbajtje.

Vlerësimi i arritjes së objektivit:

Zbatimi i plan-programit të ri në të gjitha shkollat e Kosovës ka filluar tek këtë vit, pas një periudhe relativisht të gjatë të përgatitjes dhe pilotimit. Plan-programi i ri inicion një ndryshim rrënjësor në paradigmen e arsimit duke vënë theksin në zotësitë praktike të nxënësve. Sidoqoftë, zbatimi i suksesshëm i plan-programit varet nga aspekte të shumta të sistemit arsimor në administrim, si dhe nga kapacitetet njerëzore, infrastrukture dhe buxhetore.

Plan-programi i ri parasheh metoda të reja të mësimdhënies dhe e bën të nevojshëm trajnimin e vazhdueshëm të personelit mësimdhënës. Reforma e plan-programit gjithashtu kushtëzon metoda të reja të

vlerësimit dhe mësim-nxënies. Gjatë vitit 2017 janë organizuar trajnime për rreth 40% të mësimdhënësve rreth kornizës së kurrikulës dhe kurrikulës bërthamë. Gjithashtu është promovuar bashkëpunimi më i afërt ndërmjet shkollave, mësimdhënësve dhe koordinatorëve të fushave.

Një sfidë akute është mungesa e literaturës së përshtatshme dhe teksteve mësimore për zbatimin e plan-programit të ri. Të dhënat e dala nga analiza e arritshmërisë në PISA 2015 tregojnë se Kosova renditet si vend me kënaqshmëri të ulët të drejtorëve dhe mësimdhënësve me tekstet mësimore. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe sistemit të vlerësimit të

nxënësve në bazë të objektivave të plan-programit së ri. Kjo kërkon trajnimin e mësimdhënësve, drejtorëve të shkollave dhe inspektorëve të

arsimit, gjë që nënkupton se nevojitet një mbështetje më e lartë financiare për arritjen e këtyre nevojave.

3.6

ARSIMI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL

Ky objektiv mundohet të ofrojë zgjidhje për sfidat e arsimit profesional dhe arsimit për të rritur. Këto sfida janë të shumta dhe ndërlidhen me fusha të tjera, si sektori privat, i cili do të duhej të jetë i gatshëm dhe kompetent për të bashkëpunuar për ngritjen e cilësisë në arsimin profesional. Një tjetër vështirësi është se ende mungon Kurrikula Bërthamë e veçantë për arsim profesional.

Mundësitë për trajnimin praktik të nxënësve në shkollë apo ndërmarrje janë të kufizuara, gjë që natyrisht ndikon në cilësinë e ulët të arsimit profesional. PSAK gjithashtu thekson buxhetin e

pamjaftueshëm për ngritjen e cilësisë në arsimin profesional. Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për të Rritur është themeluar në bazë të Ligjit nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, dhe ka për qëllim mbikëqyrjen dhe zhvillimin e arsimit dhe aftësimin profesional dhe për të rritur në Kosovë.

Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe për të Rritur, i themeluar në bazë të Ligji nr. 04/L- 138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, është organ këshillëdhënës për politikat e AAP-së dhe arsimimin e të rriturve në Kosovë.

Vlerësimi i arritjes së objektivit:

Gjatë vitit 2017 janë ndërmarrë disa hapa në rishikim dhe hartim të profileve. Sidoqoftë, numri i tyre është ende i vogël krahasuar me numrin e përgjithshëm të profileve që ofrohen në kuadër të shkollave të mesme profesionale. Gjatë vitit 2017 MASHT ka themeluar grupet e ekspertëve për të zhvilluar standardet për profilet e rishikuara, mirëpo Plani i Veprimit të PSAK-ut nuk e ka caktuar llojin dhe numrin e standardeve që duhet hartuar.²⁰ Deri më tani janë kompletuar 24 profile me standarde të profesionit.

Gjatë vitit 2017 ka filluar edhe hartimi i plan-programit bërthamë për arsimin profesional, por akoma nuk ka përfunduar. Edhe pse hartimi i plan-programeve për fusha sektoriale akoma nuk ka filluar, të paktën është marrë vendimi për plan-programe modulare.

Plani i Veprimit parasheh zbatimin e disa aktiviteteve për të inkuadruar të gjithë nxënësit në praktikë

profesionale në shkollë dhe jashtë shkollës. Për kompanitë që pranojnë nxënësit të arsimit profesional në praktikë është paraparë zbritje në tatime, përmes Ligjit për Arsim Profesional në Kosovë. Sidoqoftë, gjatë vitit 2017 nuk janë ndërmarrë veprime për të jetësuar këtë lloj bashkëpunimi me kompanitë në Kosovë.²¹

Në lidhje me këshillim në karrierë për nxënësit e arsimit profesional, MASHT ka zhvilluar platformën elektronike Busulla.com, përmes së cilës nxënësit mund të informohen rreth mundësive të punësimit, të bëjnë testet IVAP (interesi, vlerat, aftësitë, preferencat), të informohen rreth profesioneve, etj..

Analiza e kërkesës dhe ofertës në arsimin profesional është në fazën e hershme të zhvillimit. Këto vështirësi në përcaktimin e kërkesës në treg ndërlidhen me mungesën e familjarizimit dhe komunikimit ndërministror për të ofruar informatat e nevojshme. Në Kosovë nuk ekziston ndonjë institut apo organ i cili i përkushtohet analizës së tregut të punës.

²⁰MASHT, 119.

²¹MASHT, 123.

Kjo ka për pasojë edhe paqartësitë në lidhje me orientimin e ofertës arsimore në arsim profesional dhe vështirësitë e vlerësimit të cilësisë së menaxhimit të arsimit.

Arsimi profesional në përgjithësi shihet si alternativë e paevitueshme tek atëherë kur nxënësit nuk arrijnë suksesin që kërkohet për t'u regjistruar në gjimnaze. Kjo ka të bëjë, në njërin anë, me cilësinë e ulët të arsimit profesional, por edhe me një qëndrim të dëmshëm nënvlerësues të shoqërisë ndaj arsimit profesional. Ekziston bindja se mënyra më e lehtë për punësim është mbarimi i studimeve universitare. Kjo duhet të adresohet përmes fushatave të ndryshme të vetëdijesimit për nxënësit, prindërit dhe ekonominë.

Cilësia e arsimit profesional ndërlidhet ngushtë me investimet në infrastrukturë dhe në pajisje, të paktën për profilet ekzistuese në Kosovë. Prandaj do të duhej që Qeveria të përfill Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, ku arsimi është shpallur prioritet,

dhe në përputhje me këtë të ndajë edhe buxhetin për investimet në fushat e nevojshme në arsim.

Për sigurimin e cilësisë së jashtme të shkollave në arsim profesional është përgjegjës Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Në kuadër të AKK janë trajnuar koordinatorët për sigurimin e cilësisë dhe është bërë validimi i 19 kualifikimeve dhe akreditimi i mbi 33 institucioneve private që ofrojnë arsim profesional. AKK gjithashtu ka zhvilluar verifikimin e mbi 40 standardeve të profesionit.²²

²²MASHT, "Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017–2021," 28.

Ky objektiv synon përmirësimin e gjendjes në arsimin e lartë (universitar). Fokusi ka qenë në sigurimin e jashtëm të cilësisë, gjë që realizohet përmes mbështetjes së Agjencisë Kosovare për Akreditim dhe zbatimin e të sistemit për mbledhjen e të dhënave në arsimin e lartë (SMIAL). Është diskutuar

shumë financimi i institucioneve të arsimit të lartë mbi bazë të performancës, i cili nuk është aplikuar deri tani. Një sistem i tillë rrit përgjegjësinë e institucioneve të arsimit të lartë për rezultatin e punës së tyre. Zbatimi i këtij sistemi do të duhej të fillonte sa më shpejtë që të jetë e mundur.

Vlerësimi i arritjes së objektivit:

Shkalla bruto e përfshirjes në arsimin e lartë është rritur në vazhdimësi që nga viti akademik 2010/2011. Bazuar në të dhënat e fundit të vitit akademik, 2016/2017, një shkallë bruto prej rreth 69.4% të studentëve të grupmoshave 18–22 vjeç ndjekin arsimin e lartë. Me përparimet e shënuara vitet e fundit, Kosova renditet më lart se vendet e tjera të rajonit për nga shkalla bruto e përfshirjes të studentëve. Rritja e shkallës së përfshirjes së qytetarëve në

arsimin e lartë nuk nënkupton në mënyrë të domosdoshme ndonjë kontribut të theksuar në rritjen e produktivitetit të fuqisë punëtore. Produktiviteti varet nga cilësia e ofertës arsimore dhe përputhja e fushave të diplomimit me tregun e punës.

Gjatë viteve 2016 – 2017 kanë diplomuar rreth 14,000 studentë në nivele dhe programe të ndryshme studimesh, ku sektori privat kontribuon me rreth 35% të të

diplomuarve. Megjithatë, shkalla e përfundimit të studimeve brenda afatit të paraparë kohor në institucionet publike është relativisht e ulët.²³ Në përgjithësi, numri i studentëve është rritur në fushat e studimit të shërbimeve (juridik, administrim biznesi dhe shkencë shoqërore). Numri i studentëve i orientuar në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë është i ulët. Rritja e numrit të të diplomuarve në këto fusha do të mund të stimulonte konkurrueshmërinë e vendit në prodhim dhe përpunim industrial. Orientimi i studentëve në bujqësi dhe veterinari gjithashtu vazhdon të jetë i ulët.

Gjatë vitit akademik 2017/2018 janë akredituar dhe ri-akredituar 344 programe studimi të të gjitha niveleve. Shumica e programeve të studimit janë të nivelit baçelor dhe master. Numri i programeve të doktoratës është krahasimisht i vogël (22 programe).

Arsimi i lartë publik ofron kryesisht programe në fushat

e studimit të edukimit, bujqësisë dhe inxhinierisë. Sektori privat i arsimit të lartë përqendrohet kryesisht në administrim biznesi, juridik dhe shërbime.²⁴

Numri i studentëve që mbarojnë studimet dhe diplomojnë në institucionet publike të arsimit të lartë vazhdon të jetë nën 20%. Kjo ka të bëjë edhe me personelin e pamjaftueshëm akademik për drejtime të caktuara, por edhe me neglizhimin e caktimit të një numri të kufizuar të mundësive për kalimin e provimeve nga ana e studentëve. Kjo do të ishte një shtytje për disiplinimin e studentëve për arritje të caqeve, por në të njëjtën kohë do të eliminonte kandidatët e pasuksesshëm nga studimet, gjë që gjithashtu do të zvogëlonte ngarkesën e punës së personelit akademik dhe ngarkesën e madhe të universiteteve.

Institucionet universitare publike të themeluara nëpër komunitat e tjera kanë ndjekur një model të zhvillimit të Universitetit të Prishtinës, duke mos e diversifikuar

²³MASHT, "Raport Vjetor i Vlerësimit," 131.

²⁴MASHT, 133.

ofertën arsimore sipas
kërkesave të tregut të punës
në rajonin e tyre.

Një mangësi në sistemin e
arsimit të lartë është edhe
angazhimi i ulët i personelit
mësimdhënës në lidhje me
punime shkencore. Akoma nuk

është ndërmarrë ndonjë
aktivitet për ta ndryshuar këtë
gjendje. Ministria duhet të
ndërmarrë hapa për motivimin
e hulumtimeve dhe
publikimeve shkencore
relevante për zhvillim të
industrisë.

4

NIVELI PARASHKOLLOR

Në Kosovë ekzistojnë gjithsej 43 institucione parashkollore publike, të shpërndara në 22 komuna. Në këto institucione janë të përfshirë 22,157 fëmijë. Njëkohësisht funksionojnë edhe 88 institucione parashkollore private të licencuara nga MASHT, ku janë të përfshirë edhe 3,020 fëmijë.²⁵

Numri i institucioneve parashkollore është shumë i vogël për nevojat e shoqërisë. Sidomos për grup-moshat 0-5-vjeçare, mungesa e hapësirave adekuate dhe edukatoreve ka rezultuar në regjistrimit e vetëm një numri të vogël të fëmijëve. Shqetësues mbetet numri i ulët i fëmijëve në nivelin parashkollor të hershëm, 0-3 vjeç, gjë që është larg

përmbushjes së standardeve evropiane. Sipas statistikave të MASHT-it, regjistrimi i fëmijëve të grup-moshave 0-4 vjeç në institucione parashkollore të licencuara është vetëm 2.8%, ndërsa i grup-moshave 3-5 vjeç është 29.6%.²⁶ Në nivelin parafillor (5-6 vjeç) statistikave e përfshirjes janë më të larta, ku përqindja arrin në 79.6%.²⁷

Institucionet parashkollore funksionojnë sipas plan-programeve për edukimin parashkollor për moshat 3-6 vjeç.²⁸ Për momentin ende janë në proces të hartimit plan-programet bërthamë për këtë nivel.

Ndërsa për moshën 0-6 vjeç, institucionet punojnë me standardet e zhvillimit të UNICEF.²⁹

²⁵Numri i institucioneve private parashkollore në komuna: Fushë-Kosovë 6, Prishtinë 50, Gjiilan 3, Mitrovicë 3, Peje 5, Ferizaj 5, Gjakovë 2, Prizren 5, Suharekë 2, Viti 1, Klinë 1, Lipjan 1, Drenas 1, Krushë e Vogël 1

²⁶Plani Strategjik i Arsimit Në Kosovë 2017-2021, 22.

²⁷MASHT, 22.

²⁸Kurrikula e Edukimit Parashkollor 3-6, https://masht.rks-govnet/uploads/2015/05/kurrikula-e-edukimit-parashkollor-ne-kosove-3-6-vjec_1.pdf

²⁹Developmnet Standards for Preschool, https://masht.rks-govnet/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-web_1.pdf

4.1

NUMRI I INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE

Në tërë Kosovën funksionojnë 43 institucione parashkollore publike dhe 88 institucione private të licencuara. Numri i fëmijëve në institucionet parashkollore dhe parafillore publike është 25,966, prej tyre, 3,809 fëmijë të grup-moshës

0-5 vjeç dhe 22,157 të grup-moshës 5-6 vjeç. Numri i fëmijëve në institucionet private parashkollore është 3,020, prej tyre 2,083 të grup-moshës 0-5 vjeç dhe 937 të grup-moshës 5-6 vjeç.³⁰

4.2

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE

Mungesa e numrit të mjaftueshëm të institucioneve parashkollore vërehet në të gjitha komunat. Nëpër qytete dhe komuna më të mëdha ka numër më të madh të institucioneve parashkollore. Megjithatë ky numër nuk është i mjaftueshëm. Në Prishtinë, për shembull, ekzistojnë 8 institucione parashkollore publike, mirëpo institucione parashkollore private të licencuara që veprojnë në Prishtinë janë 50.

Kjo tregon për nevojën e lartë të qytetarëve për institucione parashkollore në kryeqytet. Fatkeqësisht ende ka komuna të cilat nuk e kanë asnjë institucion parashkollor. Nga 34 komunat që gjenden në listat e të dhënave për sistemin e arsimit në Kosovë, vetëm 22 komuna kanë institucione parashkollore. Çuditërisht, edhe Prizreni, i cili në nivelin parafilor (5-6 vjeç) njihet 1,814 fëmijë, nuk ka ndonjë çerdhe për grup-

³⁰MASHt dhe ASK, "Statistikat e Arsimit Në Kosovë-2016-17," 59.

moshat më të vogla. Gjithashtu Malisheva, me 1,136 fëmijë në nivel parafillor, nuk ka çerdhe. Institucione parashkollore nuk ka as në Deçan, Dragash, Han të Elezit, Junik, Leposaviq, Novobërdë, Shtërpçë, Zubin Potok dhe Kllokot.

Përkundër nevojës për rritjen e numrit të institucioneve publike për nivelin parashkollor, "për shkak të

kufizimeve buxhetore është përzgjedhur qasja tjetër – rritja e pjesëmarrjes në arsimin parafillor, që ka shpenzime shumë më të vogla. Gjithashtu do të stimulohet hapja e institucioneve parashkollore private dhe me bazë në komunitet."³¹ Tabela 1, në vijim, paraqet numrin e fëmijëve në nivel parashkollor dhe në nivel parafillor nëpër komuna.

Numri i institucioneve dhe nxënësve në nivelin parashkollor/parafillor ³²				
#	Komunat	Institucionet parashkollore	Numri i fëmijëve në parashkollor, Grup-mosha 0-5 vjeç (2016)	Numri i fëmijëve parafillor, Grup-mosha 5-6 vjeç (2016)
1	Deçan	-	-	483
2	Dragash	-	4	304
3	Ferizaj	2	306	1619
4	Fushë-Kosovë	1	142	164
5	Gjakovë	7	291	1120
6	Gjilan	3	246	1125
7	Glllogoc	2	98	984
8	Hani i Elezit	-	-	142
9	Istog	5	181	544

³¹MASHT, "Plani Strategjik i Arsimit Në Kosovë 2017-2021," 40.

³²Statistikat e Arsimit në Kosovë 2016-17, 16ff.

10	Junik	-	-	55
11	Kaçanik	1	88	452
12	Kamenicë	1	52	277
13	Klinë	1	115	574
14	Leposaviq	-	-	-
15	Lipjan	1	58	909
16	Malishevë	-	-	1136
17	Mamushë	1	-	56
18	Mitrovicë	1	340	1067
19	Novobërdë	-	-	46
20	Obiliq	1	82	322
21	Pejë	1	211	1187
22	Podujevë	1	46	1173
23	Prishtinë	8	1079	2530
24	Prizren	-	89	1814
25	Rahovec	1	10	882
26	Shtërpcë	-	-	42
27	Shtime	1	41	396

28	Skënderaj	1	73	483
29	Suharekë	1	55	718
30	Viti	1	86	488
31	Vushtrri	1	116	721
32	Zubin Potok	-	-	11
33	Zveçan	-	-	-
34	Klllokot	-	-	9
	Gjithsej	43	3,809	22,157

INSTITUCIONET ARSIMORE NË NIVELIN PARAUNIVERSITAR

Numri i institucioneve në arsimin parauniversitar i të gjithave niveleve në Kosovë është 1,114. Numri i shkolla të nivelin fillor (klasat 1 – 5) dhe të mesëm të ulët (klasat 6 – 9) është 952. Në nivelin e mesëm të lartë (klasat 9 – 12) funksionojnë 119 shkolla.

Në vitin 2016/2017 mësimin në nivelin parauniversitar në Kosovë e kanë vijuar 360,237 nxënës. Nga ky numër, 22,157 ishin të nivelit parashkollor, 132,438 nxënës ishin duke vijuar mësimin në nivelin fillor, 115,386 në nivelin e mesëm të ulët dhe 86,447 në nivelin e mesëm të lartë.

Numri total i nxënësve në nivelin parauniversitar në institucionet publike në Kosovë është 360,237.³³ Nëse këtij numri i shtohet edhe numri i nxënësve në institucionet private të licencuara, i cili është 9,072, atëherë numri total i nxënësve për një vit është 369,309.

Në Kosovë arsimit fillor dhe i mesëm i ulët është i detyrueshëm, prandaj shkalla e përfshirjes së nxënësve në këto nivele ka qenë çdoherë e lartë, me 96% në arsimin fillor, përkatësisht me 98% në arsimin e mesëm të ulët. Shkalla e përfshirjes së nxënësve në arsimin e mesëm të lartë gjatë vitit shkollor 2014/15 ka qenë 84.5%.³⁴

Akoma nuk është arritur standardi i hapësirës së mjaftueshme në shkolla për nxënës, dhe mungesa e hapësirave për laboratorë dhe mësim praktik akoma mbetet e theksuar. Mirëpo, për shkak të kufizimeve buxhetore, në njërin anë, dhe ndryshimeve demografike që priten në vitet në vijim, në anën tjetër, nuk janë ndërmarrë veprime për ta adresuar çështjen e mungesës së hapësirës së nevojshme në shkolla. Një tjetër arsye është se ka pasur lëvizje nga pjesët rurale në ato urbane, kështu

³³Statistikat e Arsimit në Kosovë 2016/2017, 23.

³⁴MASHT, "Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017–2021," 22.

që shkollat në disa pjesë rurale janë gjysmë të mbushura, ndërsa ato në qytete të stërngarkuara.

Përpos mungesës së hapësirës, shkollat në shumë raste përballen me mungesë të mjeteve të konkretizimit për ofrimin e mësimin sipas kërkesave të plan-programit të ri. Në përgjithësi, objektivi i

përdorimit të mjeteve të teknologjisë informative mbetet ende i paplotësuar për shkak të mungesës së kompjuterëve të mjaftueshëm për nxënës dhe vështirësive të mësimdhënësve për të ofruar një mësimdhënie të orientuar në shfrytëzimin e teknologjisë informative.

5.1

NUMRI I NXËNËSVE SIPAS NIVELEVE

Në Kosovë, numri i përgjithshëm i studentëve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në arsim publik dhe privat është 369,309. Tabela në vijim paraqet shifrat sipas niveleve.

Numri i nxënësve në nivelin para-universitar në të gjitha nivelet në shkollat publike dhe private				
#	Nivelet	Publik	Privat	Gjithsej (sipas niveleve)
1	Parashkollor	3,809	2,083	5,892
2	Parafillos	22,157	937	23,094
3	Fillor / i mesmëm i ulët	247,824	3,107	250,931
4	E mesme e lartë	86,447	2,945	89,392
	Gjithsej	360,237	9,072	369,309

Komunitat	Niveli parafilior		Niveli fillor	Niveli i mesëm i ulët	Niveli i mesëm i lartë		Gjithsej
	0-5 vjeç	5-6 vjeç			Shkolla profesionale	Gjimnaze	
Deçan	-	483	2,268	2,040	496	832	6,119
Dragash	4	304	1,934	1,634	390	207	4,473
Ferizaj	306	1,619	8,887	7,867	3,904	2,881	25,464
Fushë-Kosovë	142	164	3,339	2,656	853	750	7,904
Gjakovë	291	1,120	6,806	6,110	2,531	1,820	18,678
Gjilan	246	1,125	6,390	5,875	3,149	2,313	19,098
Gillogoc	98	984	4,791	4,157	1,607	1,424	13,061
Hani i Elezit	-	142	796	617	-	343	1,898
Istog	181	544	2,998	2,599	626	1,044	7,992
Junik	-	55	305	254	-	220	834
Kaçanik	88	452	2,512	2,211	736	790	6,789
Kamenicë	52	277	1,823	1,735	575	876	5,338
Klinë	115	574	3,196	2,922	970	844	8,621
Leposaviq	-	-	12	17	-	-	29
Lipjan	58	1,136	4,878	4,304	1,236	1,870	13,255
Malishevë	-	277	5,211	4,630	1,214	2,098	14,289
Mamushë	-	56	370	331	-	221	978
Mitrovicë	340	1,067	6,111	5,084	2,694	1,757	17,053

Novobërdë	-	46	267	214	61	-	588
Obiliq	82	322	1,703	1,508	440	308	4363
Pejë	211	1187	7095	6033	3244	1744	19514
Podujevë	46	1173	7317	6636	2836	1724	19,732
Prishtinë	1,079	2,530	16,674	13,492	5,813	5,328	44,916
Prizren	89	1,814	12,413	10,572	4,319	3,444	32,572
Rahovec	10	882	4135	3,681	534	1,932	11,253
Shtërpcë	-	42	247	268	13	169	739
Shtime	41	396	2178	2103	696	842	6256
Skenderaj	73	718	4083	3692	1,722	909	11,197
Suharekë	55	807	4,628	4,016	1,841	1,352	12,699
Viti	86	488	3432	3,174	930	1,534	9,644
Vushtrri	116	721	5473	4826	2032	1409	14577
Zubin Potok	-	11	59	50	-	-	120
Zveçan	-	-	41	17	-	-	58
Klllokot	-	9	66	61	-	-	136
	3,809	22,157	132,438	115,386	45'462	40'985	360'237
Gjithsej		25,966		247,824		86'447	360'237

Tabela në vijim e paraqet shpërndarjen e studentëve sipas niveleve dhe komunave.

Krahas institucioneve publike, një numër i nxënësve e vijon mësimin në institucione private të arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Tabela në vijim paraqet numrin dhe komunat që ofrojnë arsim privat. Numri i përgjithshëm i nxënësve në institucionet private është 6,052.

Nxënësit në institucionet private të arsimit në nivelin fillor/të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë ¹⁶									
Komunat	Fillor/ i mesëm i ulët			I mesëm i lartë			Gjithsej		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Ferizaj	26	31	57	78	31	109	104	62	166
Gjakovë	80	55	135	150	110	260	230	165	395
Gjilan	50	28	78	73	68	141	123	96	219
Klinë	-	-	-	26	30	56	26	30	56
Lipjan	-	-	-	194	187	381	194	187	381
Mitrovicë	22	22	44	5	10	15	27	32	59
Pejë	56	27	83	83	46	129	139	73	212
Prishtinë	1,070	834	1,904	778	571	1,349	1,848	1,405	3,253
Prizren	458	348	806	262	243	505	720	591	1,311
Gjithsej	1,762	1,345	3,107	1,649	1,296	2,945	3,411	2,641	6,052

¹⁶Statistikat e arsimit në Kosovë 2016-2017. 61.

5.2

NUMRI I INSTITUCIONEVE SIPAS NIVELEVE

Komunat	Parashkollor / çerdhe	Fillor dhe i mesëm i ulët	I mesëm i lartë	Gjithsej
Deçan	-	21	2	23
Dragash	-	35	1	36
Ferizaj	2	51	8	61
Fushë-Kosovë	1	13	3	17
Gjakovë	7	51	9	67
Gjilan	3	41	8	52
Gillogoc	2	32	2	36
Hani i Elezit	-	6	1	7
Istog	5	26	3	34
Junik	-	1	1	2
Kaçanik	1	24	2	27
Kamenicë	1	30	33	34
Klinë	1	26	2	29
Leposaviq	-	1	-	1
Lipjan	1	50	5	56
Malishevë	-	38	3	41
Mamushë	1	1	1	3

Mitrovicë	1	39	5	45
Novobërdë	-	7	1	8
Obiliq	1	16	2	19
Pejë	1	39	6	46
Podujevë	1	57	4	62
Prishtinë	8	58	14	80
Prizren	-	71	14	85
Rahovec	1	34	4	39
Shtërpcë	-	5	1	6
Shtime	1	18	1	20
Skenderaj	1	36	4	41
Suharekë	1	41	3	45
Viti	1	35	3	39
Vushtrri	1	46	3	50
Zubin Potok	-	1	-	1
Zveçan	-	1	-	1
Klllokot	-	1	-	1
Gjithsej	43	952	119	1114

5.3

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E SHKOLLAVE

Në Kosovë viteve të fundit është vënë re një trend i zhvillimit demografik, i cili e ka bërë edhe më të vështirë punën e planifikimit të arsimit. Lëvizja e qyterarëve nga komunat e vogla drejt qendrave të mëdha ka pasur për pasojë që një numër i shkollave nëpër fshatra dhe komuna të vogla funksionojnë me një numër të vogël të nxënësve apo janë mbyllur fare. Ndërsa në anën tjetër

shkollat nëpër qytete janë të stërngakuara dhe punojnë me ndërrime.

Në Kosovë shkollat janë të shpërndara në të gjitha komunat. Qasja e nxënësve në shkollë në përgjithësi nuk është e vështirë, sidomos viteve të fundit pas rregullimit të infrastrukturës rrugore dhe lëvizjes së autobusëve edhe nëpër pjesët e thella rurale.

5.4

NXËNËSIT QË PËRFUNDOJNË KLASËN E 9 / 10, GJIMNAZISTËT

Në Kosovë në vitin 2016/2017 kanë përfunduar arsimin e mesëm të ulët publik (klasën 9) 30,910 nxënës. Në arsimin e mesëm të lartë (klasën 10) në të njëjtin vit kanë qenë të regjistruar 32,577 nxënës.

Viti 2016 / 2017			
Grup-moshat / Klasat	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Klasa 9	15,863	15,047	30,910
Klasa 10	17,250	15,327	32,577

Niveli i arsimit të mesëm të lartë në Kosovë përbëhet nga shkollat profesionale dhe gjimnazet. Gjatë vitit 2016/2017 në shkolla profesionale ishin të regjistruar 45,462 nxënës, ndërsa në gjimnaze 40,985.

Gjimnazet preferohen nga nxënësit kosovarë, sepse kjo u mundëson vazhdimin e studimeve në universitet. Zhvillimi i dobët ekonomik, mungesa e vendeve të punës dhe fryrja e administratës shtetërore kanë sjellë krijimin e një përshtypjeje të qytetarët se punësimi bëhet më i lehtë nëse ke studiuar.

Fatkeqësisht, arsimi profesional shihet si alternativë vetëm kur nxënësit nuk arrijnë suksesin që kërkohet për t'u regjistruar në gjimnaze. Sipas MASHT-it, numri i nxënësve të regjistruar në shkollat profesionale ka rënë nën 50% të numrit të përgjithshëm të nxënësve në nivelin e mesëm të lartë. Kritikat kryesore ndaj arsimit profesional kanë të bëjnë me buxhetin e pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat për nxënës dhe me mospërputhshmërinë e profileve profesionale me kërkesat e tregut të punës.³⁶

Komunitet	Shkolla profesionale			Gjimnaze			Gjithsej		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Deçan	369	127	496	385	447	832	754	574	1328
Dragash	224	166	390	110	97	207	334	263	597
Ferizaj	2,165	1,739	3,904	1,364	1,517	2,881	3,529	3,256	6,785
Fushë Kosovë	526	327	853	261	489	750	787	816	1,603
Gjakovë	1,480	1,051	2,531	822	998	1,820	2,302	2,049	4,351

³⁶Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, 27.

Gjilan	1,577	1,572	3,149	1,012	1,301	2,313	2,589	2,873	5,462
Glllogoc	1,023	584	1,607	537	887	1,424	1,560	1,471	3,031
Hani i Elezit	-	-	-	157	186	343	157	186	343
Istog	481	145	626	428	616	1,044	909	761	1,670
Junik	-	-	-	127	93	220	127	93	220
Kaçanik	492	244	736	309	481	790	801	725	1,526
Kamenicë	398	177	575	368	508	876	766	685	1,451
Klinë	622	348	970	303	541	844	925	889	1,814
Leposaviq	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Lipjan	835	401	1,236	810	1,060	1,870	1,645	1,461	3,106
Malishevë	748	466	1,214	891	1,207	2,098	1,639	1,673	3,312
Mamushë	-	-	-	137	84	221	137	84	221
Mitrovicë	1,535	1,159	2,694	753	1,004	1,757	2,288	2,163	4,451
Novobërdë	33	28	61	-	-	-	33	28	61
Obiliq	297	143	440	99	209	308	396	352	748
Pejë	1,863	1,381	3,244	703	1,041	1,744	2,566	2,422	4,988
Podujevë	1,646	1,190	2,836	624	1,100	1,724	2,270	2,290	4,560
Prishtinë	3,362	2,451	5,813	2,255	3,073	5,328	5,617	5,524	11,141
Prizren	2,516	1,803	4,319	1,579	1,865	3,444	4,095	3,668	7,763

Rahovec	413	121	534	968	964	1,932	1,381	1,085	2,466
Shtërpçë	13	-	13	101	68	169	114	68	182
Shtime	410	286	696	386	456	842	796	742	1,538
Skenderaj	1,044	678	1,722	349	560	909	1,393	1,238	2,631
Suharekë	1,236	605	1,841	510	842	1,352	1,746	1,447	3,193
Viti	613	317	930	685	849	1,534	1,298	1,166	2,464
Vushtrri	1,283	749	2,032	563	846	1,409	1,846	1,595	3,441
Zubin Potok	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Zveçan	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Killokot	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	27,204	18,258	45,462	17,596	23,389	40,985	44,800	41,647	86,447

Sektori i arsimit të lartë është i rregulluar sipas Ligjit për Arsimin e Lartë, të vitit 2011.³⁷ Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë funksionon përmes institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë. Vetëm institucionet e akredituara mund të ofrojnë studime të cilat përmbullen më një titull akademik apo diplomë.³⁸

Në Kosovë në nivel të arsimit të lartë funksionojnë 9 institucione publike dhe 30 institucione private të akredituara dhe licencuara. Sipas kësaj, i bie që në Kosovë për 1 milion banorë ekzistojnë 20 institucione të arsimit të lartë, shifër kjo shumë e lartë krahasuar me mesataren në Bashkimin Evropian.

Një sfidë e vazhdueshme për tërë sistemin arsimor, pra edhe për arsimin e lartë, është ndarja etnike e arsimit. Megjithëse me Marrëveshjen e

Brukselit, të vitit 2013, ishin bërë përpjekje për të trajtuar çështjen e njohjes reciproke të diplomave, kjo nuk ka arritur të zbatohet.

Meqenëse arsimi nuk ka pasur të bëjë vetëm me edukimin, por është shfrytëzuar edhe për manipulimin politik, arsimi i lartë është bërë një tjetër arenë e fronteve etnike konkurruese. Pas luftës, serbët e Kosovës që jetojnë në Mitrovicën e Veriut kanë refuzuar të pranojnë pavarësinë e Kosovës, dhe rrjedhimisht edhe të Universitetit të Prishtinës nga sistemi arsimor serb. Në këtë refuzim ata përkrahen nga Serbia. Departamentet e Universitetit të Prishtinës në Mitrovicë janë mbajtur nën kontroll nga serbët e Kosovës, të cilët e kanë emëruar atë si Universiteti i Prishtinës në Mitrovicën e Kosovës apo UPKM.

³⁷Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë. <https://masht.rks-govnet/uploads/2015/06/02-ligji-per-arsimin-e-larte-anglisht.pdf>

³⁸SPHERE. Arsimi i Lartë në Kosovë. <https://supportthere.org/page/higher-education-kosovo>

Por, meqë ky universitet drejtohet dhe funksionon sipas sistemit arsimor të Serbisë, diplomat e tij duhet të njihen në Kosovë në mënyrë që studentët të mund të punësohen në Kosovë. Nga ana tjetër, diplomat e Kosovës nuk njihen në Serbi, gjë që e bën të pamundur që shqiptarët që jetojnë në Serbi të gjejnë punë atje.

Një çështje tjetër që kontribuon në cilësinë e dobët të arsimit të lartë është korrupsioni. Në një raport të porositur nga Këshilli i Evropës, të vitit 2017, thuhet se korrupsioni përbën "një problem të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm strukturor që ka vazhduar të përkeqësohet në vitet e fundit".³⁹

Përveç ndarjes etnike dhe korrupsionit, arsimit të lartë gjithashtu po abuzohet politikisht. Marrja e një vendi të punës në universitet si ligjërues është pothuajse e pamundur në qoftë se nuk i përket një prej partive më të forta politike. Meqenëse universiteti është vendi ku mund të influencohen studentët me vizion politik,

partitë kanë interes të vazhdueshëm që të instalojnë atje njerëzit e tyre.

Numri i studentëve në arsimin e lartë në Kosovë është rritur vazhdimisht. Nga 40,000 studentë në vitin 2004, ky numër ka rritur në 122,000 studentë në vitin 2015. Për 100,00 banorë Kosova ka 6,669 studentë, gjë që përbën dyfishin e mesatares në Bashkimin Evropian.

Rritje ka shënuar edhe numri i programeve të studimit, ndonëse, sipas hulumtimeve, ekziston një shpërputhje mes kërkesave të tregut të punës dhe programeve të arsimit të lartë.

Tabela në vijim paraqet përqindjen e studentëve nëpër programet e studimeve⁴⁰

³⁹Balkan Insight, <http://www.balkaninsight.com/en/article/higher-education-is-reinforcing-kosovo-s-ethnic-divide-04-04-2017>

⁴⁰MASHT, "Plani Strategjik i Arsimit Në Kosovë 2017–2021," 29.

Fushat studimore	Publik	Privat	Gjithsej
Edukimi	9.2%	0.0%	6.8%
Shkencat humane dhe artet	10.8%	6.4%	9.7%
Shkencat shoqërore, biznesi dhe drejtësia	48.1%	63.7%	52.1%
Shkencat e natyrës, matematika dhe kompjuterika	5.5%	10.2%	6.7%
Inxhinieria, prodhimtaria dhe ndërtimi	14.0%	7.5%	12.3%
Bujqësia dhe veterina	2.6%	0.0%	2.0%
Shëndeti dhe Mirëqenia	6.9%	7.7%	7.1%
Shërbimet	2.8%	4.5%	3.3%

Si një nga arsytet e mungesës së koordinimit mes institucioneve të arsimit të lartë dhe tregut të punës shihet të jetë mungesa e komunikimit ndërmjet akterëve të këtyre dy fushave.

Rritja e numrit të studentëve, përkundër nevojës së lartë, nuk është përcjellë me rritjen proporcionale të stafit akademik në institucionet e arsimit të lartë. Për më tepër, gjithashtu mungon infrastruktura dhe pajisjet për

përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë. Një nga shërbimet kyçe që duhet të ofrojnë një universitet është qasja në literature të përditësuar në biblioteka dhe në formë elektronike. Kjo do ta ngrinte cilësinë e arsimit të lartë, por edhe të kërkimeve shkencore. Megjithatë, kjo edhe më tej vazhdon të mbetet sfida për Kosovën.

Megjithëse korniza ligjore për arsimin e lartë parasheh

zhvillimin e mekanizmave për financimin e bazuar në performancë për institucionet e arsimit të lartë, Kosova akoma nuk ka hartuar një metodologji për një financim të tillë. Shpenzimet publike për arsimin e lartë kanë janë rritur

që nga viti 2011, mirëpo mbesin në kufi të standardeve evropiane. Megjithatë, shpenzimet për kokë studentij janë në rënie, për shkak të shtimit të numrit të studentëve.

6.1

NUMRI I UNIVERSITETEVE PUBLIKE DHE ATYRE PRIVATE

Në Kosovë ekzistojnë 9 universitete publike, në këto komuna:

- Prishtinë, Hasan Prishtina;
- Prizren, Ukshin Hoti;
- Pejë, Haxhi Zeka;
- Gjiilan, Kadri Zeka;
- Gjakovë, Fehmi Agani;
- Mitrovicë, Isa Boletini;
- Ferizaj, Universiteti i Shkencave të Aplikuara;
- Fakulteti i Studimeve Islame; dhe
- Vushtrri, Fakulteti për Siguri Publike.

1

UNIVERSITETI HASAN PRISHTINA,
PRISHTINË⁴¹

A	Viti I			Viti II			Viti III			Viti IV			Viti V			Viti VI			Fetëra		Mashkuj	Gjithsej
	F	M		F	M		F	M		F	M		F	M		F	M		F	M		
Filozofik	506	283	789	572	236	808	1094	445	1539	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2,172	964	3,136
Shkenca Matematike-Natyrore	526	292	818	614	261	875	546	277	823	152	141	293	-	-	-	-	-	-	-	1,838	971	2,809
Fakulteti filologjik	613	228	841	453	126	579	660	164	824	460	78	538	-	-	-	-	-	-	-	2,186	596	2,782
Juridik	639	450	1,089	748	507	1,255	734	454	1,188	850	802	1,652	-	-	-	-	-	-	-	2,971	2,213	5,184
Ekonomik	918	1,176	2,094	914	993	1,907	2,369	2,319	4,688	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	4,201	4,488	8,689
Ndërtimtari e Arkitekturë	133	345	478	165	321	486	255	875	1,130	71	70	141	97	103	200	-	-	-	-	721	1,714	2,435
Inxh. Elektrike Kompjuterike	236	459	695	170	280	450	332	434	766	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	738	1,173	1,911
Inxhinieri Mekanike	71	444	515	95	313	408	75	274	349	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	241	1,031	1,272
Mjekësi	283	142	425	357	208	565	789	373	1,162	264	165	429	298	185	483	454	493	947	2,445	1,566	4,011	
Arte	102	79	181	91	74	165	120	101	221	94	89	183	-	-	-	-	-	-	-	407	343	750
Bujqësi dhe Veterinari	256	478	734	243	305	548	128	236	364	5	43	48	5	86	91	-	-	-	-	637	1,148	1,785
Shkenca Sportive	69	134	203	52	141	193	29	104	133	39	217	256	-	-	-	-	-	-	-	189	596	785
Edukim	495	40	535	879	56	935	891	43	934	921	100	1,021	-	-	-	-	-	-	-	3,186	239	3,425
Gjithsej	4,847	4,550	9,397	5,353	3,821	9,174	8,022	6,099	14,121	2,856	1,705	4,561	400	374	774	454	493	947	2,1932	1,7042	3,8974	

⁴¹MAShT dhe ASK, "Statistikat e Arsimit në Kosovë-2016-17," 93.

2

UNIVERSITETI UKSHIN HOTI,
PRIZREN⁴²

Programet e studimeve	Viti I			Viti II			Viti III			Viti IV			Femra	Meshkuj	Gjithsej
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej			
Administrim Biznesi	163	253	416	119	88	207	114	114	228	-	-	-	396	455	851
Menaxh. Ndërkombëtar	91	163	254	90	80	170	106	109	215	-	-	-	287	352	639
Juridik	221	250	471	246	145	391	137	79	216	61	23	84	665	558	1223
Softëare design	18	134	152	25	63	88	17	45	62	-	-	-	60	242	302
TIT gjuhë boshnjake	10	29	39	8	21	29	24	16	40	-	-	-	42	66	108
TIT	30	153	183	47	79	126	60	92	152	-	-	-	137	324	461
TIT gjuhë turke	16	30	46	9	1	10	-	-	-	-	-	-	25	31	56
Gjuhë angleze	186	83	269	102	13	115	45	7	52	-	-	-	333	103	436
Gjuhë gjermane	103	74	177	39	21	60	20	11	31	-	-	-	162	106	268
Gjuhë shqipe	111	47	158	64	24	88	70	-	70	-	-	-	245	71	316
Programi fillor gj.boshnjake	25	19	44	15	7	22	23	3	26	15	9	24	78	38	116
Programi fillor gj.turke	16	13	29	7	5	12	18	7	25	15	1	16	56	26	82
Programi fillor	353	46	399	137	127	264	165	16	181	102	14	116	757	203	960
Parashkollor	214	2	216	227	1	228	142	1	143	85	1	86	668	5	673
Parashkollor Gjuhë turke	25	3	28	11	-	11	21	-	21	17	1	18	74	4	78
Parashkollor gjuhë Boshnjake	8	4	12	9	1	10	-	-	-	-	-	-	17	5	22

⁴²MASht dhe ASK. 99.

Kimi fizikë-gj. Boshnjake	-	-	-	-	-	-	-	-	-	5	8	13	5	8	13
Kimi fizikë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Mat-informatikë, turqisht	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Agrobiznes	11	42	53	-	-	-	-	-	-	-	-	-	11	42	53
Shkencat e pyjes dhe mjedisit	9	58	67	-	-	-	-	-	-	-	-	-	9	58	67
Gj. angleze edukim	-	-	-	-	-	-	-	-	-	14	10	24	14	10	24
Gj. shqipe edukim	-	-	-	-	-	-	-	2	2	-	1	1	-	3	3
Gj. gjermane edukim	-	-	-	6	1	7	6	12	18	3	17	20	15	30	45
Gjithsej	1,610	1,403	3,013	1,161	677	1,838	968	514	1,482	317	85	402	4,056	2,740	6,796

3

UNIVERSITETI HAXHI ZEKA, PEJË⁴³

Numri i përgjithshëm i studentëve në nivelin bachelor në Universitetin Haxhi Zeqa, Pejë

Programet e studimeve	Viti I			Viti II			Viti III			Viti IV			Gjithsej		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Fakulteti i Biznesit	355	548	903	221	196	417	356	226	582	-	-	-	932	970	1,902
Fakulteti Juridik	572	1231	1803	235	270	505	244	195	439	254	180	434	1305	1876	3,181
Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis	141	431	572	112	241	353	95	157	252	-	-	-	348	829	1,177
Fakulteti i Agrobiznesit	124	141	265	92	81	173	98	179	277	-	-	-	314	401	715
Fakulteti i Arteve	40	70	110	20	23	43	11	27	38	18	15	33	89	135	224
Gjithsej	1,232	2,421	3,653	680	811	1,491	804	784	1,588	272	195	467	2,988	4,211	7,199

4

UNIVERSITETI KADRI ZEKA, GJILAN⁴⁴

Fakultetet / Programet e studimeve	Viti I			Viti II			Viti III			Viti IV			Gjithsej		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Edukim/ Fillor	152	34	186	146	17	163	85	16	101	71	19	90	454	86	540
Edukim/ Parafillor	127	-	127	106	-	106	60	-	60	42	-	42	335	-	335
Juridik/ Juridik	212	178	390	156	83	239	147	63	210	48	38	86	563	362	925
Ekonomik/ Banka, Financa dhe Kontabilitet	121	120	241	118	80	198	128	66	194	-	-	-	367	266	633
Ekonomik/ Menaxhment	100	139	239	99	61	160	105	86	191	-	-	-	304	286	590

⁴³MASht dhe ASK. 104.

⁴⁴MASht dhe ASK. 107.

Ekonomik/ Marketing	81	50	131	36	9	45	33	9	42	-	-	-	150	68	218
Shkenca Komputerike	46	107	153	28	45	73	20	30	50	-	-	-	94	182	276
Gjithsej	839	628	1467	689	295	984	578	270	848	161	57	218	2267	1250	3517

5 UNIVERSITETI FEHMI AGANI, GJAKOVË⁴⁵

Programet e studimeve	Viti I			Viti II			Viti III			Viti IV			Gjithsej		
	Femra	Meshku	Gjithsej	Femra	Meshku	Gjithsej	Femra	Meshku	Gjithsej	Femra	Meshku	Gjithsej	Femra	Meshku	Gjithsej
Edukim Parashkollor	108	2	110	125	2	127	142	4	146	136	4	140	511	12	523
Edukim Fillor	103	20	123	154	43	197	124	29	153	146	33	179	527	125	652
Filologji / Gjuhë shqipe	50	28	78	63	57	120	37	40	77	38	23	61	188	148	336
Filologji / Letërsi shqipe	38	43	81	41	58	99	39	34	73	-	-	-	118	135	253
Filologji / Gjuhë dhe letërsi angleze	-	-	-	98	46	144	69	25	94	46	30	76	213	101	314
Mjekësi / Mami	57	1	58	58	-	58	39	1	40	36	1	37	190	3	193
Mjekësi / Infermieri	86	24	110	121	48	169	99	36	135	71	19	90	377	127	504
Gjithsej	442	118	560	660	254	914	549	169	718	473	110	583	2,124	651	2,775

⁴⁵MASHt dhe ASK. 110

6

UNIVERSITETI ISA BOLETINI,
MITROVICË⁴⁶

Programet e studimeve	Viti I			Viti II			Viti III					
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Gjeoshkenca	22	139	161	12	44	56	26	92	118	60	275	335
Teknologji Ushqimore	157	150	307	64	35	99	92	46	138	313	231	544
Inxhinieri Mekanike dhe Kompjuterike	126	298	424	123	114	237	86	119	205	335	531	866
Juridik	82	101	183	35	35	70	24	26	50	141	162	303
Ekonomik	81	181	262	58	65	123	39	44	83	178	290	468
Edukim	200	14	214	175	16	191	91	3	94	466	33	499
Gjithsej	668	883	1551	467	309	776	358	330	688	1493	1522	3.015

7

UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA,
FERIZAJ⁴⁷

Programet e studimeve	Viti I			Viti II			Viti III					
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Fakulteti i Menaxhmentit	124	133	257	89	62	151	73	71	144	286	266	552
Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit	96	91	187	56	51	107	15	11	26	167	153	320
Fakulteti i Arkitekturës dhe Teknologjisë së Drurit	57	81	138	34	32	66	21	31	52	112	144	256
Fakulteti i Inxhinierisë me Informatikë	47	82	129	13	34	47	7	22	29	67	138	205
Gjithsej	324	387	711	192	179	371	116	135	251	632	701	1.333

⁴⁶MASHT dhe ASK. 113.⁴⁷MASHT dhe ASK. 117.

8

FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME⁴⁸

Programet e studimeve	Viti I			Viti II			Viti III			Viti IV			Gjithsej		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Teologji Islame	40	78	118	40	45	85	41	58	99	23	30	53	144	211	355

9

FAKULTETI PËR SIGURI PUBLIKE,
VUSHTRRI⁴⁹

Programet e studimeve	Viti I			Viti II			Viti III			Viti IV			Gjithsej		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Siguri Publike	6	56	62	5	50	55	7	55	62	-	-	-	18	161	179

⁴⁸MASHT dhe ASK, 120.⁴⁹MASHT dhe ASK, 122.

6.2

KOLEGJET PRIVATE

Numri i studentëve në Baçelor në kolegjet private⁵⁰

Kolegjet	KOLEGJET PRIVATE														
	Viti I		Viti II		Viti III		Viti IV		Viti V		Viti VI				
	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
AAB	2.463	4.561	1.941	3.659	2.017	4.143	735	1.200	-	-	-	-	7.156	6.407	13.563
AuK	60	145	63	121	40	87	35	74	-	-	-	-	198	229	427
Biznesi	127	514	139	546	129	529	42	98	-	-	-	-	437	1.250	1.687
Design FactorY	20	20	21	24	6	6	-	-	-	-	-	-	47	3	50
Fama	885	1.266	567	924	647	1.198	99	313	-	-	-	-	2.198	1.503	3.701
European i Kosovës	24	91	23	73	58	157	-	-	-	-	-	-	105	216	321
Dukagjini	36	105	46	131	25	110	10	18	-	-	-	-	117	247	364
Gjilani	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Humanistika	1	3	6	33	15	42	-	-	-	-	-	-	22	56	78
IBMC	39	100	27	46	25	41	13	21	-	-	-	-	104	104	208
Internacional	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
ISPE	152	424	220	544	218	541	13	39	-	-	-	-	603	945	1.548
Juridika	37	116	39	105	25	105	18	88	33	100	32	123	184	453	637
Pjeter Budi	44	152	40	184	38	236	-	-	-	-	-	-	122	450	572
QEAP Heimerer	347	488	312	446	238	324	-	-	-	-	-	-	897	361	1.258
Rezonanca	320	559	287	509	202	351	26	66	33	88	-	-	868	705	1.573

⁵⁰MASHT dhe ASK. 123.

Riinvest	30	79	23	99	68	255	-	-	-	-	-	-	121	312	433
Tempulli	16	108	8	43	3	45	-	-	-	-	-	-	27	169	196
UBT	1.013	2.616	581	1.832	517	1.813	9	33	-	-	-	-	2.120	4.174	6.294
Universi	140	214	111	176	111	171	-	-	-	-	-	-	362	199	561
Akademia Evolucion	151	202	119	165	115	167	-	-	-	-	-	-	385	149	534
Dardania	274	399	273	443	306	470	-	-	-	-	-	-	853	459	1.312
ESLG	10	35	31	74	22	49	3	5	-	-	-	-	66	97	163
Iliria	278	806	406	1.243	412	1.305	98	198	-	-	-	-	1.194	2.358	3.552
Universum	325	657	265	610	299	641	166	140	-	-	-	-	1.055	1.293	2.348
Vizioni për Arsim	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ekonomik i Lubljanës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Eada	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Victory	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Globus	99	204	54	114	58	129	-	-	-	-	-	-	211	236	447
Arbëri	57	161	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	57	104	161
Gjithsej	6.948	14.025	5.602	12.144	5.594	12.915	1.267	2.593	66	188	32	123	19.509	22.479	41.988

Numri i studentëve në nivelin Master në kolegje private në vitin 2016/2017⁵¹

Kolegjet	Viti I		Viti II				
	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
AAB	535	965	402	766	937	794	1731
AuK	-	-	-	-	-	-	-
Biznesi	62	175	55	197	117	255	372
Design FactorY	-	-	-	-	-	-	-
Fama	138	229	187	321	325	255	550
Europian i Kosovës	-	-	-	-	-	-	-
Dukagjini	15	33	6	20	21	32	53
Gjilani	-	-	-	-	-	-	-
Humanistika	-	-	-	-	-	-	-
IBMC	-	-	-	-	-	-	-
Internacional	-	-	-	-	-	-	-
ISPE	13	38	34	103	47	94	141
Juridika	3	17	6	25	9	33	42
Pjeter Budi	17	52	12	51	29	74	103
QEAP Heimerer	34	38	12	13	46	5	51
Rezonanca	42	56	-	-	42	14	56

⁵¹MASht dhe ASK. 128.

Riinvest	31	51	142	300	173	178	351
Tempulli	13	44	-	18	13	49	62
UBT	131	345	108	225	239	331	570
Universi	-	-	2	6	2	4	6
Akademia Evolucion	10	15	9	12	19	8	27
Dardania	29	45	55	83	84	44	128
Dukagjini	15	33	6	20	21	32	53
ESLEG	16	46	-	-	16	30	46
Iliria	140	294	137	314	277	331	608
Universum	33	56	45	120	78	98	176
Vizioni për Arsim	-	-	-	-	-	-	-
Ekonomik i Lubjanës	-	-	-	-	-	-	-
Eada	-	-	-	-	-	-	-
Victory	-	-	-	-	-	-	-
Globus	61	109	40	72	101	80	181
Arbëri	13	39	-	-	13	26	39
Gjithsej	1,336	2,647	1,252	2,646	2,588	2,705	5,293

6.3

NUMRI I NXËNËSVE DHE STUDENTËVE NË TË GJITHA NIVELET NË ARSIMIN PUBLIK DHE PRIVAT⁵²

Arsimi	Publik	Privat	Gjithsej
	2016/2017	2016/2017	2016/2017
Parashkollor (0)	26,453	3,020	29,473
Fillor dhe i mesëm i ulët (1+2)	251,986	3,107	255,093
I Mesëm i lartë (3)	87,996	2,945	90,941
Arsimi special (1+2+3)	271	-	271
Universitar (5+6)	75,962	47,281	123,243
Gjithsej	442,668	56,353	499,021

⁵²Statistikat e Arsimit në Kosovë 2016/2017, 134.

7

PLAN-PROGRAMET (KLASAT 6 – 12): SI AFTËSOHEN NXËNËSIT PËR JETËN DEMOKRATIKE DHE TË TREGUT TË PUNËS?

Në kuadër të përpjekjeve për reformimin e arsimit në Kosovë, me qëllim të adresimit të mangësive dhe përmbushjes së nevojave të identifikuar në fushën e arsimit është hartuar Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar. Plan-programet e mëhershme edhe më tej kanë qenë të orientuar në arsimin si transmetim të përmbajtjeve dhe mësimdhënies frontale, me përqendrim në mësimdhënësin dhe lëndën mësimore. Me plan-programin aktual, i cili është pilotuar në vitin 2011 dhe, sipas parashikimeve të MASHT-it, është dashur të jetë në funksion në të gjithë vendin që në vitin 2013/2014, synohet një ndryshim i paradigmës së mësimdhënies klasike, të orientuar në përmbajtje, dhe zhvendosja e fokusit te nxënësit dhe zhvillimi i zotësive të ndryshme praktike te nxënësit. Megjithatë, deri

më tani ka pasur vonesa në zbatimin e Kornizës së re të Kurrikulës. Zbatimi i plan-programit të ri është bërë i detyrueshëm për të gjitha shkollat tek në vitin 2017.

Korniza e Kurrikulës zërthehet në Kurrikulat Bërthamë të niveleve të ndryshme të arsimit Parauniversitar. Në kuadër të Kurrikulës Bërthamë përcaktohen rezultatet, si për zotësitë praktike, ashtu edhe për të nxënëit.

Zotësitë praktike që parashihet të zhvillohen përmes Kornizës së re të Kurrikulës dhe Kurrikulave Bërthamë përfshijnë njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve të arrijnë sukses në epokën digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë në një botë me ndërvarshmëri të theksuar. Llojet e zotësive praktike që synohet të zhvillohen janë:

- Zotësitë e komunikimit dhe të të shprehurit;
- Zotësitë e të të menduarit;
- Zotësitë e të të mësuarit;
- Zotësitë për jetë, punë dhe mjedis;
- Zotësitë personale; dhe
- Zotësitë qytetare.

Për arritjen e këtyre zotësive praktike janë formuluar rezultatet që kërkohet të arrihen për fushave të ndryshme të plan-programit, si në vijim:

- Gjuhët dhe komunikimi;
- Artet;
- Matematika;
- Shkencat e natyrës;
- Shoqëria dhe mjedisi;
- Edukata fizike, sportet dhe shëndeti;
- Jeta dhe puna.

Dallimi mes niveleve formale të arsimit për kompetencat dhe fushat kurrikulare bëhet përmes rezultateve të pritura të të nxënit.⁵³

Kurrikulat bërthamë për arsimin e mesëm të ulët (klasat VI – IX)⁵⁴ dhe arsimin e mesëm të lartë (klasat X –

XII)⁵⁵ parashohin kompetencat dhe fusha të plan-programeve të njëjta, si për nivelin e ulët, edhe për atë të lartë (gjimnazet). Përpos lëndëve klasike, plan-programet kurrikulat e të dy nivele kanë planifikuar edhe dy fusha të plan-programeve që trajtojnë

⁵³Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët të Kosovës, gusht 2016, 15.

⁵⁴MASHT, "Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët të Kosovës."

⁵⁵MASHT, "Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës," gusht 2016.

tema sociale (Shoqëria dhe Mjedisi) dhe ekonomike (Jeta dhe Puna).

Përmes fushës Shoqëria dhe mjedisi nxënësit zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe prirjet që janë të nevojshme për një shoqëri demokratike. Synohet që nxënësit të mësojnë të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive e kritike në

shoqëri dhe botë.

Fusha e plan-programit Shoqëria dhe mjedisi për arsimin e mesëm të ulët (klasat VI – IX) realizohet përmes mësimin lëndor. Lëndët mësimore të kësaj fushe në këtë nivel janë: historia, gjeografia dhe edukata qytetare.

Konceptet e përgjithshme të kësaj fushe janë:

- Individit, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore
- Proceset shoqërore dhe natyrore
- Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë
- Vendimmarrja dhe institucionet
- Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm⁵⁶

Konceptet specifike të fushës Shoqëria dhe mjedisi⁵⁷ për arsimin e mesëm të ulët përfshijnë, përpos koncepteve nga lëndët histori dhe gjeografi, edhe koncepte të lëndës edukata qytetare, të cilat trajtojnë tema sociale dhe politike.

Arsimi i mesëm i ulët, konceptet specifike për fushën shoqëria dhe mjedisi				
Shoqëria	Mbretëria	Paqja	Liria	Demokracia
Revolucioni	Familja	Barazia	Abolicionizmi	Republika
Iluminizmi	Individi	Ligjet	Toleranca	Migrimi
Parlamentarizmi	Insitucionet	Qytetaria Demokratike	Absolutizmi	Kommunikimi
Kolonializmi	Gjinia	Shteti	Qeverisja	Totalitarizmi

⁵⁶MASHT, "Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët të Kosovës," 66

⁵⁷MASHT, "Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët të Kosovës, f. 70.

Në arsimin e mesëm të lartë (klasat X – XII) fusha kurrikulare Shoqëria dhe Mjedisi trajtohet përmes mësimin lëndor siç janë historia, edukata qytetare, sociologjia, psikologjia, filozofia

dhe logjika.

Konceptet specifike të fushës Shoqëria dhe Mjedisi në arsimin e lartë, të cilat trajtojnë edhe tema sociale, politike dhe ekonomike janë.⁵⁸

Arsimi i mesëm i lartë, konceptet specifike për fushën Shoqëria dhe Mjedisi				
Shoqëria	Dekolonizimi	Normat	Paqja	Parlamentarizmi
Kolonizimi	Të drejtat	Përgjegjësitë	Toleranca	Konflikti
Partitë politike	Solidariteti	Diktatura	Fashizmi	Perceptimi
Neokolonializmi	Vendimmarrja	Diktatura e Proletariatit	Ekonomia e Tregut	Racizmi
Traktati	Iluminizmi	Individi	Komunizmi	Shteti
Barazia	Socializmi	Gjykimi	Marrëdhëniet shoqërore	Liria
Qytetaria	Grupet shoqërore	Demokracia	Epoka e relativizmit	Lufta
Të menduarit	Civilizimi	Rrymat filozofike		

Në kuadër të fushës së plan-programit Jeta dhe puna planifikohen aktivitetet si hulumtimet, zgjidhja e problemeve dhe shqyrtimi i koncepteve. Nxënësit pritet të zhvillojnë kreativitetin e tyre dhe shkathtësi ndërmarrëse. Këto aftësi e shkathtësi kërkohet të zhvillohen në mënyrë që nxënësit të mund të luajnë një rol efektiv në

ekonomi, duke qenë konkurrentë në tregun e punës. Kjo fushë e plan-programit përfshin: Shkathtësitë për jetë, Punëdore, Ekonomi shtëpiake, Këshillimin dhe orientimin në karrierë, Teknologjinë dhe TIK-un, Edukimin për punë në profesion dhe ndërmarrësi, Edukim për zhvillimin e qëndrueshëm.

⁵⁸MASHT, "Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës," 70.

Konceptet e përgjithshme:

- Teknologjia, përfshirë TIK-un;
- Puna dhe edukimi për ndërmarrësi;
- Këshillimi dhe orientimi në karrierë;
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm

Për arsimin e mesëm të ulët (klasat VI – IX) konceptet specifike të fushës Jeta dhe Puna janë si në tabelën në vijim.

Arsimi i mesëm i ulët, konceptet specifike për fushën Jeta dhe Puna			
Përshkrimi	Matje	Prerje	Planifikim
Identifikim	Vlerësim	Krijim modelesh	Qasje e problemeve nga perspektiva të ndryshme
Zbatim	Dizajnim	Hulumtim	Arsyetim

Konceptet specifike për fushën Jeta dhe Puna për arsimin e mesëm të lartë janë si në tabelën në vijim.

Arsimi i mesëm i lartë, konceptet specifike për fushën Jeta dhe Puna			
CV	Pajisjet kompjuterike	Sistemi i karrierës	Çështjet e qasjes nga perspektiva të ndryshme
Plani i biznesit	Rrjeti i komunikimit	Zhvillimi i qëndrueshëm	Dizajni (Kreativiteti)
Gjuha programuese	Ndërmarrësia	Krijimi i modeleve	Kërkimet shkencore
Biznesi	Ekonomia	Orientimi në karrerë	Tregu i punës
Të arsyetuarit	Planifikimi	Argumentimi	Punëshënësi

Për të aftësuar nxënësit për të dhënë kontributi në jetën demokratike dhe tregun e punës është e këshillueshme të zgjerohen fushat e koncepteve specifike për fushat Shoqëria dhe Mjedisi dhe Jeta dhe Puna në atë mënyrë që të përfshijnë edhe koncepte të edukimit politik,

etikës dhe politikave të tregut të punës. Fokusi do të duhej të ishte kryesisht në konceptet, të cilat përbëjnë hallkat e proceseve të jetës dhe punës në një shoqëri demokratike.

8

OFRIMI I KËSHILLIMIT PËR KARRIERË

Këshillimi për Karrierë është diskutuar si temë edhe në kuadër të Kornizës së Kurrikulës dhe Kurrikulave Bërthamë. Në vitin 2012 MASHT ka hartuar Strategjinë për Orientim në Karrierë. Megjithatë, për shkak të mungesës së zyrtarëve dhe këshilltarëve të trajnuar dhe profesionalë për orientimin për karrierë, në Kosovë ka pasur vonesa në këtë objektiv.

Në vitin 2015, në kuadër të një tryeze rreth kësaj çështjeje, të organizuar nga projekti Enhancing Youth Employment, mungesa e këtyre zyrtarëve

dhe angazhimi i pamjaftueshëm është diskutuar edhe nga ana e MASHT-it. Në dhjetor 2016 është publikuar një hulumtim nga Iniciativa për Progres (INPO), i cili udhëzon themelimin e qendrave për këshillim për karrierë.⁵⁹

Në dokumentet e konsultuara në faqen zyrtare të MASHT nuk janë gjetur informata rreth ndonjë iniciative për themelimin e qendrave për orientim dhe këshillim në karrierë.

⁵⁹INPO, Udhëzues për Themelimin e Qendrave për Orientim në Karrierë, <http://advocacy-center.org/wp-content/uploads/2017/02/Udhezues-per-themelimin-e-Qendrave-per-Orientim-ne-Karriere.pdf>.

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIMET

Me gjithë përpjekjet e shtuara gjatë vitit të kaluar për reformimin e sistemit arsimor në Kosovë, ende ka punë për t'u bërë në shumë fusha.

Mangësitë më të mëdha shënohen në vijim, në përpjekje që të renditen çështjet më kyçe, sipas prioritetit të tyre.

Mangësitë:

- Mungesa e koordinimit ndërministror, qeveritar, në lidhje me çështjet e arsimit
- Mosrespektimi i prioriteteve të Strategjisë për Zhvillim Kombëtar nga ana e Qeverisë
- Buxheti i vogël për arsimin
- Mungesa e monitorimit të zbatimit të legjislacionit në të gjitha nivelet e sistemit arsimor dhe e harmonizimit të legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e arsimit
- Keqinterpretimet e legjislacionit ekzistues rreth përgjegjësive dhe kompetencave të akterëve të ndryshëm në lidhje me cilësinë e arsimit
- Menaxhmenti i shkollës i pakualifikuar për detyrën e drejtorit sipas kërkesave të PSAK-ut
- Mësimdhënësit e pa-trajnuar për mësimdhënien sipas plan-programit të ri dhe mos-funksionalizimi i sistemit të licencimit dhe pagesës së mësimdhënësve sipas performancës
- Qytetarët të painformuar rreth të drejtave dhe detyrave të tyre për sigurimin e cilësisë në arsim
- Mungesa e lëndëve të edukimit politik, etikës dhe politikave të tregut të punës
- Mungesa e vetëdijes tek të gjitha palët rreth arsimit si përgjegjësi publike.

Rekomandimet:

- Duhet të formohet një organ monitorues dhe planifikues për sistemin e arsimit, i cili do të përbëhej nga zyrtarë të MASHT-it, të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Ky organ monitorues dhe planifikues do të ishte gjithashtu përgjegjës për monitorimin e arritjes së qëllimeve shtetërore, sipas kërkesave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim.
- Një strategji nuk mund të ketë sukses pa monitorim të vazhdueshëm dhe raportim. Mirëpo, në rast të mosarritjes së objektivave sipas planit të veprimit për strategjitë e caktuara, duhet të ketë edhe llogaridhënie për ato dështime. Nëse dështimet nuk dënohen, vonesat dhe ngecjet e Kosovës do të vazhdojnë në të gjitha sferat e jetës.
- Për caqet e caktuara dhe të shpallura si prioritet nga ana e Qeverisë duhet të ketë një ndarje buxheti në përputhje me nevojat për arritjen e atyre caqeve. Duhet të ndalohet menjëherë mungesa e llogaridhënies edhe nga ana e Qeverisë.
- Duhet të caktohet një organ përgjegjës për harmonizimin dhe interpretimin e legjislacionit në fushën e arsimit.
- Duhet të bëhet e qartë se përgjegjësia në lidhje me sigurimin e cilësisë së arsimit është përgjithësisht detyrë e Ministrisë së Arsimit. Për këtë duhet të zhvillohen standardet dhe udhëzuesit përkatës dhe të fuqizohet Inspektorati i Arsimit në aspekt financiar dhe me personel.
- Drejtorët e shkollave duhet të jenë menaxherë të dëshmuar dhe profesionalë dhe përzgjedhja e tyre të mos ndikohet politikisht.
- Të gjithë mësimmshënësit të trajnohen për mësimmshënien sipas plan-programit të ri dhe të paguhën sipas performancës së tyre. Kosovës nuk i duhen mësimmshënës të dobët. Duhet të bëhet testimi periodik i njohurive dhe shkathtësive të mësimmshënësve për të ofruar mësim praktik dhe motivues, sipas kërkesave të plan-programit të ri.
- Qytetarët duhet të kuptojnë se është detyrë e tyre të insistojnë për cilësinë e arsimit për fëmijët e tyre. Institucionet publike paguhën nga taksat e qytetarëve dhe janë përgjegjëse për të ofruar shërbimet kualitative për të cilat paguhën. Qytetarët duhet

të informohen përmes fushatave mbi të drejtat dhe detyrat të tyre në lidhje me sigurimin e cilësisë. Gjithashtu duhet të zhvillohen fushata vetëdijesimi rreth rëndësisë së arsimit profesional dhe paragjyqimeve të gabuara ekzistuese në lidhje me arsimin profesional.

- Duhet të ofrohen lëndë që e ngritin edukimin politik, të etikës dhe politikave të tregut të punës. Kjo do të sigurojë që nxënësit vërtet të jenë pjesëtarë aktivë në jetën demokratike dhe të sjellin një vlerë të shtuar profesionale në shoqëri dhe në tregun e punës.
- Të gjithë akterët institucionalë të Qeverisë dhe administratës shtetërore duhet të vetëdijesohen se cilësia në arsim dhe arsimit si i tillë është përgjegjësi publike, dhe se për dështime duhet të ndëshkohen personat përgjegjës.

Balkan Insight, Higher Education is Reinforcing Kosovo's Ethnic Divide, <http://www.balkaninsight.com/en/article/higher-education-is-reinforcing-kosovo-s-ethnic-divide-04-04-2017> [accessed 20.09.2018]

Evropa e lirë, «Arsimi prioritet i Qeverisë pas asfaltimit të rrugëve», <https://www.evropaelire.org/a/28238678.html>

INPO, Udhëzues për Themelimin e Qendrave për Orientim në Karrierë,

MASHT, "Kurrikula Bërthamë Për Arsimin e Mesëm Të Lartë Të Kosovës," Gusht 2016.

"Kurrikula Bërthamë Për Arsimin e Mesëm Të Ulët Të Kosovës," Gusht 2016.

"Kurrikula për Arsimin Parshkollor 3-6. 2015,
https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/kurrikula-e-edukimit-parashkollor-ne-kosove-3-6-vjec_1.pdf

"Plani Strategjik i Arsimit Në Kosovë 2017-2021," 2016

"Raport Vjetor i Vlerësimit," 2018.

Standardet e Zhvillimit UNICEF, https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-web_1.pdf

"Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020," 2015

MASHT, and ASK, "Statistikat e Arsimit Në Kosovë-2016-17." Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim, 2017.

Portali Telegrafi, „Rritjet dhe shkurtime të buxhetore të vitit 2018»,
<https://telegafi.com/rritjet-dhe-shkurtime-të-buxhetore-te-vitit-2018/>

SPHERE, Higher Education in Kosovo,
<https://supporthere.org/page/higher-education-kosovo>
[accessed 20.09.2018]

Qeveria e Kosovës, Zyra për Planifikim Strategjik. “Strategjia Kombetare për Zhvillim 2016–2021.” 2015.

Ligjet

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës
[qasur me 22 korrik 2018]

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës,
[qasur me 22 korrik 2018]

Ligji për Arsimin në Komuna,
<http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/9ligji-i-arsimit-ne-komuna2008-03-1068-al-ar-se-kom.pdf> [qasur me 22 korrik 2018]

Ligji për Vetëqeverisje Lokale,
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>, [qasur me 22 korrik 2018]

Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë,
<http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/4-2004-37-al.pdf>, [qasur me 22 korrik 2018]

Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2761> [qasur me 20.09.2018]



Analizë e sistemit arsimor në Kosovë